



Manual

Për Vëzhgimin e Regjistrimit të Zgjedhësve

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike
dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)
Ul. Miodowa 10, 00-251 Varshavë, Poloni.
www.osce.org/odihr

© OSCE/ODIHR 2018

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirisht për qëllime edukimi dhe për qëllime të tjera jotregtare, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një shënim ku thuhet se burimi është OSBE/ODIHR-i.

ISBN 978-92-9234-984-4

Fotografia e kopertinës nga OSBE/Urdur Gunnarsdottir

Dizajni nga Nona Reuter

Shtypur në Poloni nga Centrum Poligrafii Sp. z o.o

PASQYRA E LËNDËS

| | |
|--|-----------|
| I. HYRJE | 5 |
| A. Rreth këtij manuali | 5 |
| B. Rëndësia e regjistrimit të zgjedhësve | 6 |
| C. Angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare | 7 |
| D. Qasja e ODIHR-it ndaj vëzhgimit të regjistrimit të zgjedhësve | 9 |
| II. TERMINOLOGJI E DOBISHME | 11 |
| A. Identiteti dhe vendbanimi | 11 |
| B. Regjistrimi i zgjedhësve dhe të dhënat bazë të listës së zgjedhësve | 12 |
| C. Regjistrat e zgjedhësve dhe listat e zgjedhësve | 13 |
| D. Përditësime të regjistrave të zgjedhësve dhe të listave të zgjedhësve | 13 |
| E. Gabime të mundshme gjatë përditësimeve | 15 |
| F. Mbyllja e regjistrave të zgjedhësve | 16 |
| G. Censusi dhe regjistrimi i popullsisë | 17 |
| III. TIPARE TË PËRGJITHSHME TË SISTEMEVE TË REGJISTRIMIT TË ZGJEDHËSVE | 19 |
| A. Regjistrimi aktiv dhe pasiv i zgjedhësve | 19 |
| B. Regjistrimi i vazhdueshëm dhe periodik i zgjedhësve | 20 |
| C. Regjistrat në letër dhe regjistrat elektronikë | 20 |
| D. Përgjegjësia administrative për regjistrimin e zgjedhësve | 21 |
| IV. KUADRI LIGJOR PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE | 23 |
| A. Fusha e vlerësimit ligjor | 23 |
| B. Kriteret për të votuar | 25 |
| 1. Shtetësia | 25 |
| 2. Kriteret lidhur me moshën | 26 |
| 3. Kriteret lidhur me vendbanimin | 26 |
| 4. Pezullimi i së drejtës për të votuar | 27 |
| C. Kërkesa për përditësime të informacionit në regjistrin e zgjedhësve dhe të të dhënave bazë në listat e zgjedhësve | 28 |
| D. Mbrojtja e të dhënave personale | 29 |

| | |
|--|-----------|
| V. VLERËSIMI I TRANSPARENCËS | 31 |
| A. Rreth transparencës | 31 |
| B. Periudha për këqyrje nga publiku | 32 |
| C. Informimi i zgjedhësve | 33 |
| VI. VLERËSIMI I SAKTËSISË | 35 |
| A. Rreth saktësisë | 35 |
| B. Garantimi i regjistrave të saktë | 36 |
| C. Probleme të zakonshme | 38 |
| D. Vështirësitë në marrjen e masave të posaçme për votim | 39 |
| 1. Zgjedhësit brenda vendit, larg vendbanimit të tyre | 39 |
| 2. Zgjedhësit jashtë vendit | 40 |
| 3. Votimi paraprak | 41 |
| 4. Votimi i lëvizshëm ose nga shtëpia | 41 |
| 5. Votimi elektronik dhe përdorimi i teknologjive të reja të votimit | 42 |
| E. Auditimet e regjistrimit të zgjedhësve | 42 |
| 1. Testimet kompjuterike | 43 |
| 2. Testimet në terren | 43 |
| VII. VLERËSIMI I GJITHËPËRFSHIRJES DHE MOSDISKRIMINIMIT | 45 |
| A. Pjesëmarrja e pakicave kombëtare | 45 |
| B. Pjesëmarrja e grave | 47 |
| C. Pjesëmarrja e personave të zhvendosur | 48 |
| D. Pjesëmarrja e të pastrehëve | 49 |
| VIII. LISTAT E ZGJEDHËSVE DHE DITA E ZGJEDHJEVE | 51 |
| A. Struktura e listave të zgjedhësve | 51 |
| B. Votimi | 52 |
| C. Numërimi | 53 |
| D. Vëzhgimi në ditën e zgjedhjeve | 54 |
| E. Dita pas zgjedhjeve | 55 |

Hyrje

A. Rreth këtij manuali

Ky manual ka për qëllim të ofrojë disa orientime për mënyrën se si duhet trajtuar regjistrimi i zgjedhësve në kuadër të vëzhgimit të përgjithshëm të zgjedhjeve. Megjithëse ODIHR-i e ka përfshirë regjistrimin e zgjedhësve në metodologjinë e vet të përgjithshme për vëzhgimin e zgjedhjeve, me këtë manual synohet të sigurohet një qasje më sistematike dhe gjithëpërfshirëse ndaj vëzhgimit të kësaj pjese shumë të rëndësishme të procesit zgjedhor.¹ Njohja më e mirë e aspekteve legjislative dhe administrative të regjistrimit të zgjedhësve do të përmirësojë punën e analistëve dhe vëzhguesve në veprimtaritë e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Ky manual synon t'u shërbejë kryesisht ekspertëve ligjorë dhe atyre të zgjedhjeve, por prej tij do të përfitojnë edhe anëtarë të tjerë të ekipeve kryesore të misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve (MVZ), si dhe vëzhguesit afatgjatë (VAGJ) dhe vëzhguesit afatshkurtër (VASH). Ndonëse ky manual synon t'u shërbejë kryesisht MVZ-ve, nga referimi ndaj manualit mund të përfitojnë edhe pjesëtarët e misioneve për vlerësimin e zgjedhjeve dhe anëtarë të veprimtarive të tjera të vëzhgimit të zgjedhjeve që zhvillon ODIHR-i. Ky i fundit shpreson që ky manual të përdoret edhe nga grupe të tjera vëzhguesish ndërkombëtarë dhe vendas në veprimtarive të tyre vëzhguese.

Manuali përfshin këto pjesë:

- ✎ **Hyrjen**, përfshirë dhe standardet përkatëse ndërkombëtare dhe qasjen e OSBE/ODIHR-it ndaj regjistrimit të zgjedhësve;
- ✎ **Terminologjinë e dobishme** për të kuptuar regjistrimin e zgjedhësve;
- ✎ Një shpjegim të **karakteristikave të përgjithshme** të sistemeve të regjistrimit të zgjedhësve;
- ✎ Orientime mbi mënyrën se si duhet rishikuar **kuadri ligjor** që lidhet me regjistrimin e zgjedhësve;
- ✎ Orientime se si duhet vlerësohet **transparenca** e regjistrimit të zgjedhësve;
- ✎ Orientime se si vlerësohet **saktësia** e regjistrimit të zgjedhësve;

¹ Ky manual duhet të lexohet bashkërisht me "Manualin e vëzhgimit të zgjedhjeve" të OSBE/ODIHR-it. Shih, gjithashtu, dokumente të tjera udhëzuese të ODIHR-it, veçanërisht "Manualin për vëzhguesit afatgjatë të zgjedhjeve", "Manualin për monitorimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje" dhe "Manualin për të ndihmuar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në procesin e zgjedhjeve". Të gjitha këto gjenden tek: <http://www.osce.org/odihr/elections/75352>.

- ✎ Orientime se si vlerësohet **gjithëpërfshirja** e regjistrimit të zgjedhësve; dhe
- ✎ Përdorimi i listave të zgjedhësve dhe vëzhgimi në **ditën e zgjedhjeve**.

Manuali bën një ndërthurje të shpjegimeve lidhur me aspekte teknike të regjistrimit të zgjedhësve dhe këshillave praktike se si duhet ta kryejnë këtë proces vëzhguesit e zgjedhësve. “Pyetjet për diskutim” në fund të disa kapitujve evidentojnë çështje praktike për çdo temë që mund të jenë të dobishme për vëzhguesit. Ky manual pasqyron gamën e gjerë të praktikave të regjistrimit të zgjedhësve që ndiqen në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Meqenëse praktikat e regjistrimit të zgjedhësve në rajonin e OSBE-së ndryshojnë nga një vend në tjetrin, çështjet që hulumtohen në këtë manual mund të mos vlejnë për çdo lloj zgjedhesh. Vëzhguesve do t’u duhet të analizojnë elemente të veçantë të procesit të regjistrimit të zgjedhësve në varësi të llojit të sistemit të regjistrimit të zgjedhësve, afatit të procesit të regjistrimit dhe procedurave të Shtetit pjesëmarrës. Se sa gjerësisht i shohin vëzhguesit këto çështje varet edhe nga koha kur ndodhin veprimtaritë vëzhguese dhe kur mbërrijnë vëzhguesit në vend, si dhe nga burimet në dispozicion të vëzhgimit. Megjithatë, në çdo rast, regjistrimi i zgjedhësve duhet mbajtur parasysh dhe duhet të përfshihet në raportim dhe, sipas rastit, edhe te rekomandimet.

B. Rëndësia e regjistrimit të zgjedhësve

Të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e kanë njohur të *drejtën universale dhe të barabartë për të votuar* si parim kryesor të procesit të zgjedhjeve demokratike dhe janë zotuar ta garantojnë atë. Regjistrimi i zgjedhësve përbën një bazë të rëndësishme për garantimin e një pjesëmarrje universale dhe të barabartë, në një lloj të caktuar zgjedhesh, të zgjedhësve që i përmbushin kriteret për të votuar. Përveç kësaj, bazuar në numrin e zgjedhësve të regjistruar, gjatë procesit të zgjedhjeve merren vendime të rëndësishme si përcaktimi i numrit të njësive administrative (zonave zgjedhore), vendndodhjes së qendrave të votimit, numrit të fletëve të votimit dhe materialeve zgjedhore që duhen shtypur dhe shpërndarë në qendrat e votimit, si dhe llogaritja e pjesëmarrjes në votim. Transparenca, saktësia dhe *gjithëpërfshirja* janë aspekte kryesore të garantimit të integritetit të procesit të regjistrimit të zgjedhësve dhe besueshmërisë së listave të zgjedhësve. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të përqendrohen në këto aspekte në vlerësimin e procesit të regjistrimit të zgjedhësve. Në këtë manual çdonjëri prej tyre do të shqyrtohet me hollësi. Proces transparent, i saktë dhe gjithëpërfshirës i regjistrimit të zgjedhësve u lejon zgjedhësve që kanë të drejtën e votimit ta ushtrojnë këtë drejtë themelore civile, duke vepruar ndërkohë si garanci ndaj tentativave për manipulimin e procesit. Lista e zgjedhësve i informon zgjedhësit për vendndodhjen specifike ku mund të votojnë dhe u konfirmon zyrtarëve të qendrave të votimit se ata kanë të drejtën e votës. Njëherazi, lista e zgjedhësve duhet të garantojë që çdo zgjedhës të ketë mundësi të votojë vetëm një herë dhe të mos lejojë të votojnë ata që nuk kanë të drejtën e votës. Gjithashtu, regjistrimi i zgjedhësve krijon mundësi për rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor. Zgjedhësit duhet të kenë mundësi për të hyrë në regjistrin e zgjedhësve përpara ditës së zgjedhjeve për të verifikuar nëse informacioni për ta është pa gabime dhe duhet të kenë mundësi të kundërshtojnë çdo pasaktësi

përmes një procesi që zhvillohet në kohën e duhur. Kopje të regjistrimit të zgjedhësve mund t'u jepen edhe partive politike dhe kandidatëve, në mënyrë që këta të kenë mundësi të verifikojnë përfshirjen në të të mbështetësve të tyre dhe për ta përdorin këtë informacion për zhvillimin e fushatave të tyre. Kur partive politike dhe kandidatëve u jepen kopje të regjistrimit të zgjedhësve, duhen mbajtur parasysh këto çështje: të gjitha palëve duhet t'u jepet akses i barabartë në regjistrin e zgjedhësve dhe informacioni duhet të jepet në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave. Përveç kësaj, mund të shihet edhe mundësia e ofrimit të regjistrimit në format elektronik për të mundësuar kërkimet në rrugë elektronike të të dhënave në pajtim me legjislacionin mbi mbrojtjen e të dhënave. Në disa vende, edhe grupe të shoqërisë civile mund të verifikojnë saktësinë e listave të zgjedhësve me anë të testimit në terren dhe testeve kompjuterike dhe t'ia paraqesin gjetjet e tyre publikut. Përveç atyre që përmenden më lart, regjistrimi i zgjedhësve mbështet edhe një sërë komponentësh të tjerë të procesit zgjedhor. Në disa Shtete pjesëmarrëse, kërkesat e partive të reja politike ose kandidatëve që kërkojnë të kandidojnë për një post të caktuar duhet të mbështeten nga firmat e një numri a përqindjeje të caktuar zgjedhësish të regjistruar. Edhe gjithëpërfshirja në regjistrin e zgjedhësve mund të shërbejë si bazë për të vendosur nëse një kandidat i plotëson apo jo kushtet për të kandiduar, veçanërisht në rastet kur sistemi kërkon që kandidati të ketë banuar në zonën zgjedhore përkatëse për një periudhë të caktuar kohe. Në disa Shtete pjesëmarrëse, fondet publike për fushatat shpërndahen në bazë të një vlere të caktuar për çdo zgjedhës që ka të drejtën e votës.

C. Angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare

Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it kanë si detyrë kryesore të vlerësojnë shkallën e përmbushjes së standardeve të OSBE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike nga zgjedhjet e vëzhguara, përfshirë edhe procesin e regjistrimit të zgjedhësve. Këto parime, si dhe praktikat e mira ndërkombëtare, përcaktojnë standardet që duhet të përmbushë ky proces dhe duhet të trajtohen si pikënisje për vlerësimin e përmbushjes së tyre nga Shtetet pjesëmarrëse. Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it iu referohen këtyre standardeve në raportet e tyre. Vëzhguesit e zgjedhjeve të ODIHR-it vlerësojnë respektimin e angazhimeve të OSBE-së dhe të standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Në Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990,² Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan t'i përmbahen një sërë parimeve për zgjedhje demokratike. Ky dokument përcakton bazën kryesore të vlerësimit të proceseve zgjedhore, përfshirë edhe regjistrimin e zgjedhësve.

Në paragrafin 6 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990, thuhet se:

“...vullneti i popullit, i shprehur lirisht dhe në mënyrë të ndershme përmes zgjedhjeve të qenësishme dhe periodike, është baza e autoritetit dhe legjitimitetit të të gjithë qeverisë. Shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë, në këtë frymë, të

² Dokumenti i “Takimit të Kopenhagenit të Konferencës së Dytë për Dimensionin Njerëzor të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE)”, Kopenhagen, 5 qershor-29 korrik 1990; shih: <http://www.osce.org/odihr/elections/14304>.

drejtën e shtetasve të tyre për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tyre, qoftë drejtpërdrejt, qoftë përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht prej tyre përmes zgjedhesh të ndershme.”

Për këtë qëllim, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar t'i përmbahen një sërë parimeve të shprehura qartë në paragrafin 7, duke përfshirë “garantimin e të drejtës universale dhe të barabartë shtetasve që kanë arritur moshën madhore”. Këto parime kanë rëndësi të veçantë sa i përket regjistrimit të zgjedhësve dhe përgatitjes së listave të zgjedhësve. Edhe instrumente të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përcaktojnë disa standarde që kanë të bëjnë me regjistrimin e zgjedhësve dhe ofrojnë një bazë për vlerësimin e tij. Në veçanti, neni 25 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)³ ka të bëjë drejtpërsëdrejti me regjistrimin e zgjedhësve: “Çdo shtetas duhet të ketë të drejtën dhe mundësinë, pa asnjë dallim dhe pa asnjë kufizim të paarsyeshëm..., të votojë dhe të zgjidhet përmes zgjedhesh të qenësishme dhe periodike, të cilat duhet të mbahen përmes një votimi universal dhe të barabartë...”

Në Komentin e Përgjithshëm 25, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, organi i ngarkuar me ofrimin e orientimeve shpjeguese për zbatimin e PNDCP-së, thuhet se:

“... Shtetet duhet të marrin masa efektive për të garantuar që të gjithë personat, që i përmbushin kriteret për të votuar, të kenë mundësi për ta ushtruar këtë të drejtë. Në rastet kur kërkohet regjistrimi i zgjedhësve, ky regjistrim duhet lehtësuar dhe nuk duhet të krijohen pengesa për një regjistrim të tillë. Nëse për regjistrimin ka kritere lidhur me vendbanimin, këto kritere duhet të jenë të arsyeshme dhe nuk duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të përjashtojnë të pastrehët nga e drejta për të votuar. Çdo ndërhyrje abuzive në regjistrim apo në votim, si dhe çdo intimidim apo shtrëngim i zgjedhësve duhet të ndalohej nga legjislacioni penal dhe ky legjislacion duhet të zbatohet në mënyrë rigorozë. Fushatat për informimin dhe regjistrimin e zgjedhësve janë të nevojshme për të garantuar ushtrimin efikas të të drejtave të parashikuara nga neni 25 nga një komunitet i informuar...”⁴

Instrumente të tjera të të drejtave të njeriut sanksionojnë garanci për mosdiskriminim. Neni 5 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (KNEFDR)⁵ parashikon se:

“Shtetet palë zotohen të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre apo origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e ... të drejtës për pjesëmarrje në zgjedhje dhe në zhvillimin e çështjeve publike.”

³ PNDCP-ja është miratuar dhe është hapur për nënshkrim nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2200A (XXI), datë 16 dhjetor 1966; ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976; shih: www.ohchr.org.

⁴ Paragrafi 11 i Komentit të Përgjithshëm 25 (“E drejta për të marrë pjesë në çështjet publike, e drejta për të votuar dhe e drejta për akses të barabartë në shërbimet publike”), miratuar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut më 12 korrik 1996; shih: www.ohchr.org.

⁵ KNEFDR-ja është miratuar dhe është hapur për nënshkrim dhe ratifikim nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2106 (XX), datë 21 dhjetor 1965; ka hyrë në fuqi më 4 janar 1969; shih: www.ohchr.org.

Po kështu, neni 7 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEDNG)⁶ parashikon se:

“Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe, në mënyrë të veçantë, t’u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën për të votuar në të gjitha zgjedhjet, si dhe të drejtën për t’u zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publikisht.”

Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës⁷ jepen udhëzime sa u takon praktikave më të mira lidhur me regjistrimin e zgjedhësve. Ky kod thekson nevojën e:

- Mbajtjes së një regjistri (regjistrave) të përhershëm zgjedhësish;
- Publikimit të regjistrit (regjistrave) të zgjedhësve;
- Përditësimit sistematik dhe të vazhdueshëm të regjistrit (regjistrave) të zgjedhësve; dhe
- Përcaktimit të procedurave administrative që i nënshtrohen kontrollit gjyqësor për të mundësuar korrigjimet në regjistrin (regjistrat) e zgjedhësve.

D. Qasja e ODIHR-it ndaj vëzhgimit të regjistrimit të zgjedhësve

Përmes veprimtarive të vëzhgimit të zgjedhjeve, veçanërisht MVZ-ve, ODIHR-i është në gjendje të vlerësojë nëse janë respektuar parimet e të drejtës universale dhe të barabartë të votimit. Komponent i rëndësishëm i një vlerësimi të tillë është vlerësimi se sa me efikasitet i shërben regjistrimi i zgjedhësve nxitjes së proceseve zgjedhore universale, me fshehtësi vote, të barabarta, të lira, të rregullta, të përgjegjshme, transparente dhe të besueshme për qytetarët. Vëzhguesit e ODIHR-it analizojnë në mënyrë të posaçme proceset që lidhen me regjistrimin e zgjedhësve në kuadër të metodologjisë së përgjithshme të vëzhgimit të zgjedhjeve. MVZ-të përpiqen të vlerësojnë veçanërisht saktësinë, gjithëpërfshirjen dhe transparencën e procesit të regjistrimit të zgjedhësve. Megjithatë shumë procedura që lidhen me regjistrimin e zgjedhësve kryhen në vazhdim ose para dërgimit të një MVZ-je, anëtarët e ekipeve të terrenit, së bashku me VAGJ-të dhe VASH-të, mundet gjithsesi të grumbullojnë informacione të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të mbështetur. Gjatë vëzhgimit të regjistrimit të zgjedhësve, është e rëndësishme të vlerësohet njëherazi si gjithëpërfshirja dhe transparenca e procesit, ashtu edhe saktësia e cilësisë së listave të zgjedhësve që përftohen prej tij.

6 KEDNG-ja është miratuar më 18 dhjetor 1979 (Rezoluta 34/180) dhe ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1981; shih: www.ohchr.org. Gjithashtu, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 23 i Komitetit për KEDNG-në (sesioni i 16-të, 1997); shih tek: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm#recom23>.

7 Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore, Opinioni Nr. 190/2002, CDL-AD (2002) 23, i rishikuar; Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Këshilli i Evropës; shih: [http://www.venice.coe.int/docs/2002/CDL-AD\(2002\)023rev-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2002/CDL-AD(2002)023rev-e.pdf).

Anëtarëve të caktuar të MVZ-ve u takon të luajnë role specifike gjatë vlerësimit të procesit të regjistrimit të zgjedhësve

- ✎ **Analisti ligjor** shqyrton me kujdes ligjet, procedurat dhe rregulloret që kanë të bëjnë me regjistrimin e zgjedhësve për të përcaktuar nëse kuadri ligjor nxit përpilimin e listave të sakta dhe gjithëpërfshirëse të zgjedhësve dhe nëse është në pajtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare;
- ✎ **Analisti i zgjedhjeve** zhvillon takime me zyrtarët e duhur, përgjegjës për hartimin e listave të zgjedhësve, qofshin në administratën qendrore të zgjedhjeve apo në ministri ose institucione të tjera për të përcaktuar si është realizuar procesi i regjistrimit të zgjedhësve;
- ✎ **Analisti politik** zhvillon takime me kandidatët dhe partitë politike për të diskutuar sa besim kanë ata në procesin e regjistrimit të zgjedhësve dhe për të dëgjuar çdo shqetësim që mund të kenë sa i takon saktësisë së listave të zgjedhësve apo procesit të regjistrimit të zgjedhësve;
- ✎ **Analisti i pakicave kombëtare** dhe **analisti për çështjet gjinore** i kushtojnë vëmendje çështjes nëse grupet që kanë qenë shpesh tradicionalisht të marxhinalizuara, si pakicat kombëtare dhe gratë, kanë mundësi të marrin pjesë plotësisht në procesin zgjedhor, duke përfshirë dhe nëse ato hasin ndonjë pengesë të caktuar ligjore apo administrative për t'u regjistruar;
- ✎ **Vëzhguesit afatgjatë** zhvillojnë takime me administratorë vendorë dhe rajonale të zgjedhjeve të përfshirë në hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të zgjedhësve për të identifikuar aspekte kryesore të krijimit dhe funksionimit të sistemit të regjistrimit të zgjedhësve në këtë nivel. VAGJ-të vëzhgojnë edhe afshimin e listave paraprake të zgjedhësve, përfshirë dhe përpunimin e përditësimeve ose korrigjimeve me kërkesë të zgjedhësve; dhe
- ✎ Në ditën e zgjedhjeve, në qendrat e votimit, **vëzhguesit afatshkurtër** mbledhin të dhëna të llojeve të ndryshme, përfshirë dhe të dhëna për identifikimin e zgjedhësve dhe përdorimin e listave të zgjedhësve. Gjatë vëzhgimit në ditën e zgjedhjeve del çdo pasaktësi e përhapur në masë në listat e zgjedhësve, duke qenë se zgjedhësit dhe përfaqësuesit e partive politike me shumë gjasë ankohen nëse ata vetë ose mbështetësit e tyre nuk gjenden në listat e zgjedhësve apo nëse dhënat për ta janë të pasakta.

Në situatat kur ka probleme të caktuara që kanë të bëjnë me regjistrimin e zgjedhësve, ODIHR-i mund të caktojë një **ekspert për çështje të regjistrimit të zgjedhësve** për të bërë një analizë më të plotë të procesit të regjistrimit të zgjedhësve. Një ekspert i tillë duhet të ketë ekspertizë të mjaftueshme teknike për të kuptuar bazat përkatëse të të dhënave kompjuterike dhe procedurat e hartimit dhe përditësimit të regjistrit të zgjedhësve.

Terminologji e Dobishme

Është e rëndësishme që vëzhguesit e zgjedhjeve të kuptojnë qartë terminologjinë dhe procedurat e regjistrimit të zgjedhësve, sidomos ngaqë ky është një proces teknik dhe i ndërlikuar. Në kapitullin vijues jepen përkufizime të termave më të përdorur për regjistrimin e zgjedhësve, si dhe shpjegime të procedurave të zakonshme në procesin e regjistrimit të zgjedhësve. Anëtarët e ekipeve të terrenit duhet të zbatojnë të njëjtën terminologji në raportimin e tyre për të shmangur çdo konfuzion lidhur me atë çka është vëzhguar.

A. Identiteti dhe vendbanimi

Zgjedhës që ka të drejtën e votës është çdo person, të cilit kushtetuta dhe legjislatoni i vendit i japin të drejtën të votojë në zgjedhje të caktuara. *Identiteti* i personit përcaktohet zakonisht nga emri dhe mbiemri i tij/saj dhe data e lindjes. Përpos këtyre, për të përcaktuar identitetin e personit, shpeshherë përdoren edhe të dhëna të tjera, siç është atësia, amësia dhe vendi i lindjes. Në disa Shtete pjesëmarrëse, çdo shtetasi i caktohet që në lindje një numër unik personal identifikimi, i cili mund të përmbajë të dhëna personale në format të hapur ose të krijuar. Pavarësisht llojit të informacionit që përmban lista e zgjedhësve, ky informacion duhet të jetë i mjaftueshëm për identifikimin e një personi. Nëse të dhënat janë të pamjaftueshme për shkak të mungesës së informacionit (p.sh.: rastet e njerëzve që nuk e dinë datën e tyre të lindjes), cenohet saktësia e regjistrimit të zgjedhësve. Veçanërisht të cenuar nga mungesa e të dhënave të sakta janë shpeshherë gratë, pakicat kombëtare, personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV-të) dhe të pastrehët.

Në përgjithësi, njerëzit banojnë për një periudhë të arsyeshme kohe në një vend që e zgjedhin vetë. Vendi, ku një person banon zakonisht, njihet si *vendbanimi* i tij. Vendbanimi siguron në shumicën e rasteve lidhjen midis identitetit të një personi dhe vendndodhjes gjeografike, ku ai/ajo ka të drejtën të hedhë votën. Në praktikë, kjo do të thotë se zgjedhësi është regjistruar që të votojë në një qendër votimi, zona e të cilës përfshin vendin e tij/të saj të banimit.

Koncepti i vendbanimit mund të përcaktohet edhe me dispozita ligjore. Në disa Shtete pjesëmarrëse, ndonëse shtetasi mund ta zgjedhin lirisht vendbanimin e tyre, ata janë të detyruar nga kuadri ligjor kërkohet t'ua njoftojnë ose ta *regjistrojnë* formalisht vendbanimin e tyre pranë autoriteteve. Nganjëherë, zgjedhja e vendbanimit kushhtëzohet

nga kritere të tjera, siç është pronësia mbi pronën, vërtetim se vendbanimi ndodhet në zona të njohura ligjrisht apo nga miratimi i pronarit për të banuar në një pronë caktuar. Disa shtete pjesëmarrëse u krijojnë shtetasve mundësinë për t'u regjistruar njëherazi si në një vendbanim të *përhershëm*, ashtu edhe në një vendbanim të *përkohshëm*.

Në disa raste, që një person të mund të votojë apo të zgjidhet, ai ose ajo duhet të ketë banuar në një vend të caktuar për një periudhë të caktuar kohe. Periudha kohore për *këtë kriter lidhur me vendbanimin*, zakonisht fillon nga data e regjistrimit të vendbanimit deri në një moment tjetër referimi që lidhet me datën e zgjedhjeve në fjalë. Kriteret lidhur me periudhën e banimit në një vend duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale në raport me qëllimin e vendosjes së tyre.⁸

Një praktikë e zakonshme në të gjithë rajonin e OSBE-së është detajimi i mëtejshëm i vendbanimit të përhershëm dhe/ose të përkohshëm, që është regjistruar, duke përfshirë edhe *adresën* e shtetasit. Zakonisht, adresa përcaktohet nga emri i rrugës dhe numri i godinës. Një tjetër interpretim i mundshëm i adresës është një vendndodhje e zgjedhur lirisht nga individ, në të cilën autoritetet mund ta komunikojnë. Përkufizimi i adresës nuk duhet të përdoret për të përjashtuar regjistrimin e të pastrehëve si votues, apo të atyre që banojnë në vendbanime që nuk njihen si të ligjshme nga autoritetet shtetërore.

B. Regjistrimi i zgjedhësve dhe të dhënat bazë të listës së zgjedhësve

Regjistrimi i një zgjedhësi që ka të drejtën e votës nënkupton një grup të dhënash që e dallon atë zgjedhës me të drejtë vote nga të gjithë zgjedhësit e tjerë me të drejtë vote. *Të dhënat bazë*, nga ana tjetër, nënkuptojnë një grup të dhënash të mjaftueshme për të identifikuar një zgjedhës me të drejtë vote në një qendër votimi në ditën e zgjedhjeve, duke marrë parasysh çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave. Zakonisht, të dhënat bazë janë një nëngrup i regjistrimit, duke qenë se regjistrimi mund të përmbajë të dhëna që nuk janë përfshirë në të dhënat bazë, kurse të gjitha të dhënat bazë janë të përfshira në regjistrim. Zakonisht, regjistrimi dhe/ose të dhënat bazë përbëhen nga disa *fusha* të dhënash, kurse çdo fushë përbëhet nga karakteret. Karakteret përfshijnë shkronja, shifra ose simbole të veçanta.

Një e dhënë bazë e listës së zgjedhësve shpeshherë përfshin, në fusha të ndryshme të të dhënave, emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes së individit. Të dhënat mund të përfshijnë edhe disa fusha ku mund të futet numri i identitetit, emri i rrugës dhe numri i godinës. Nga ana tjetër, regjistrimi i zgjedhësve mund të përfshijë informacione shtesë, siç është atësia ose amësia, gjinia, vendi i lindjes, gjendja civile, etj. Disa shtete pjesëmarrëse e konsiderojnë numrin e identitetit dhe adresën si informacion personal të mbrojtur dhe nuk i përfshijnë ato në të dhënat bazë të listave të zgjedhësve. Megjithatë, ato të dhëna janë prapëseprapë pjesë e regjistrimit përkatës.

⁸ Shih, për shembull, Kodin e Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, Seksioni I.1.1.c dhe Seksionin "Raporte shpjeguese" I.1.1.c, dhe çështjen gjyqësore të GJEDNJ-së "Py kundër Francës".

C. Regjistrat e zgjedhësve dhe listat e zgjedhësve

Regjistri i zgjedhësve është grupi regjistrimeve të të gjithë zgjedhësve me të drejtë vote për zgjedhje të caktuara. Në kontekstin e këtij manuali, termi *regjistër* i referohet njëseve administrative që përfshijnë më shumë se një qendër votimi. Teorikisht, regjistrat e zgjedhësve në nivel bashkie përfshijnë të gjithë zgjedhësit me të drejtë vote në bashki, kurse regjistri i zgjedhësve në nivel kombëtar përfshin të gjithë zgjedhësit me të drejtë vote në të gjithë vendin. Nëse ekziston një regjistër i zgjedhësve për të gjithë vendin, regjistrat e zgjedhësve, që kanë bashki ose qarqe të veçanta, do të ishin nëngrupe të tij.

Po kështu, shumë Shtete pjesëmarrëse mbajnë *regjistra të popullsisë*, që janë grupet e regjistrimeve të të gjithë shtetasve apo banorëve, përfshirë edhe shtetasit e huaj, të një bashkie ose të një vendi.⁹ Për këtë arsye, për ato Shtete pjesëmarrëse që kanë sisteme regjistrash popullore, regjistri i zgjedhësve është zakonisht një nëngrup i regjistrit të popullsisë, si sa i takon përmbajtjes së regjistrimit përkatës, ashtu dhe sa i takon plotësimin të kushteve për të qenë pjesë e tij.¹⁰ Nëse regjistri i popullsisë është elektronik, mund të mos jetë nevoja për të krijuar dhe për të mbajtur një regjistër më vete zgjedhësish, duke qenë se regjistri i zgjedhësve për zonën administrative përkatëse mund të nxirret nga regjistri i popullsisë sipas nevojës. Megjithatë, termi *regjistër zgjedhësish* do të përdoret shpesh më poshtë, pasi ka vende, ku regjistrat e zgjedhësve ekzistojnë si regjistra të ndarë, si dhe vende, ku nuk ka regjistra popullore.

Lista e zgjedhësve, krahasuar me regjistrin e zgjedhësve, nënkupton grupin e të dhënave bazë të të gjithë zgjedhësve me të drejtë vote që caktohen në një qendër votimi. Zgjedhjet mund të zhvillohen edhe pa regjistër zgjedhësish, por rrallë zhvillohen pa lista zgjedhësish. Nëse listat e zgjedhësve nxirren nga regjistri i popullsisë apo i zgjedhësve, numri total i të dhënave bazë do të ishte i barabartë me numrin e regjistrimeve në regjistrin e zgjedhësve ose me numrin e regjistrimeve të zgjedhësve në regjistrin e popullsisë.

D. Përditësimet e regjistrave të zgjedhësve dhe të listave të zgjedhësve

Ndryshimet në jetën e njerëzve që duhet të pasqyrohen në regjistrin e zgjedhësve njihen zakonisht si *ndryshime të gjendjes civile*. Një martesë apo ndarje mund të rezultojë në ndryshimin e mbiemrit, duke ndryshuar kështu parametrat formalë të identitetit të një personi. Kur shtetasit arrijnë moshën e lejuar për të votuar, ata bëhen zgjedhës që duhet të përfshihen në regjistrin e zgjedhësve dhe në listën përkatëse të zgjedhësve. Kur zgjedhësit vdesin, regjistrimet e tyre duhet të hiqen nga regjistri i zgjedhësve dhe nga lista përkatëse e zgjedhësve. Përveç kësaj, në grupin e zgjedhësve hyjnë edhe qytetarë të rinj që kanë të drejtën për të votuar; për këtë arsye, në këtë sistem duhet të përfshihen edhe agjencitë që hedhin ndryshimet në regjistrimet e natyralizimit/shtetësisë.

⁹ Shih "Manualin për regjistrimin e popullsisë" të OSBE/ODIHR-it, i cili gjendet tek: <http://www.osce.org/odihr/documents/39496>.

¹⁰ Për shembull, të miturit përfshihen në regjistrin e popullsisë, por jo në regjistrin e zgjedhësve.

Kur njerëzit *ndërrojnë vendbanim*, ekziston mundësia që t'u duhet të votojnë në një qendër tjetër votimi. Kjo nënkupton nevojën për të ndryshuar atë pjesë të regjistrimit dhe/ose të të dhënave bazë të tyre që përmban adresën. Kuptohet që, nëse zgjedhësit nuk i njoftojnë zyrtarisht autoritetet përkatëse se kanë ndryshuar vendbanim, regjistrimi i tyre do të mbetet i pandryshuar dhe të dhënat e tyre bazë në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit do të përkohjnë me adresën e fundit të regjistruar zyrtarisht.

Kur ndodhin ndryshime të gjendjes civile ose kur njerëzit ndryshojnë vendbanim, fushat përkatëse të regjistrimeve dhe të të dhënave të zgjedhësve duhet të *përditësohen*. Sistemet e mirëorganizuar të regjistrimit karakterizohen nga afatet kohore që përcaktohen me kujdes dhe që respektohen sa i përket përditësimit të regjistrave dhe informimit të institucioneve të tjera përkatëse lidhur me informacionin e përditësuar. Në rastet kur për regjistrin e zgjedhësve ekzistojnë disa burime të dhënash, është institucioni që mban të dhënat ai që duhet të mbajë përgjegjësinë e bërjes së përditësimeve.

Për qëllime të vëzhgimit të zgjedhjeve, për përshkrimin e përditësimeve të ndryshme në regjistrin e zgjedhësve përdoret kjo terminologji:

- ✎ **Shtimi** i regjistrimeve (të reja) në regjistrin e zgjedhësve përkon me përfshirjen e regjistrimit të një zgjedhësi të ri në regjistrin e zgjedhësve, kur një personi i lind e drejta e votës (p.sh.: mbush 18 vjeç; merr shtetësinë; kthehet nga jashtë vendit). Një veprim i tillë përfaqëson një të dhënë të re bazë në një listë të caktuar zgjedhësish që përkon me qendrën e votimit dhe që përfshin adresën e zgjedhësit të ri;
- ✎ **Transferimi** i një regjistrimi përkon me ndryshimin e adresës së një zgjedhësi me të drejtë vote kur regjistrimi i tij/saj në regjistrin e zgjedhësve kalohet nga lista e zgjedhësve të një qendre votimi tek një tjetër. Në kontekstin e listave të zgjedhësve, një veprim i tillë rezulton në heqjen e të dhënës bazë përkatëse nga lista e zgjedhësve e qendrës së mëparshme të votimit dhe në shtimin e një të dhëne bazë në listën e zgjedhësve të qendrës së re të votimit. Po kështu, në regjistrat kombëtarë mundet edhe që regjistrimet të transferohen nga një njësi administrative, bashki apo zonë zgjedhore vendore tek një tjetër;
- ✎ **Korrigjimi** i një regjistrimi përkon më shumë me ndryshimet që bëhen në regjistrim dhe në të dhënat bazë se sa me ndryshimin e adresës apo me të drejtën e votës. Për këtë arsye, të dhënat bazë mbeten në listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit;
- ✎ **Shuarja** e një regjistrimi përkon me humbjen e përkohshme të së drejtës së votës. Një regjistrim i tillë shuhet, por nuk fshihet nga regjistri dhe mund të aktivizohet sërish. Sidoqoftë, të dhënat bazë përkatëse fshihen nga lista e zgjedhësve për periudhën për të cilën ndodh shuarja. Po kështu, **rivendosja** e një regjistrimi përkon me rikthimin e së drejtës së votës dhe jo me shtimin e një regjistrimi të ri; dhe
- ✎ **Fshirja** e një regjistrimi dhe e të dhënave bazë përkatëse përkon me heqjen nga regjistri i zgjedhësve dhe nga lista përkatëse e zgjedhësve e regjistrimit dhe

e të dhënave bazë të një zgjedhësi, i cili e ka pasur më parë të drejtën e votës (p.sh.: kur zgjedhësi ka vdekur, ka humbur përgjithmonë të drejtën e votës ose ka humbur shtetësinë). Fshirja e regjistrimeve dhe e të dhënave bazë të listave të zgjedhësve duhet të bëhet me kujdes, pasi fshirja mund të çojë në heqjen për gjithë jetën të së drejtës së votës.

E. Gabime të mundshme në përditësime

Regjistrimi i zgjedhësve nuk është i imunizuar ndaj gabimeve pa dashje. Përditësimi i regjistrimeve dhe i të dhënave bazë kërkon vëmendje të veçantë dhe të vazhdueshme për t'i mbrojtur regjistrat dhe listat nga gabimet, pavarësisht llojit të sistemit të regjistrimit apo formatit të tij fizik apo elektronik. Zëvendësimi i paqëllimshëm i një karakteri të një regjistrimi ekzistues me një tjetër, veçanërisht në regjistrat elektronikë, mund të rezultojë në krijimin pa dashje të një regjistrimi të ri.¹¹

Profesionistët e fushës priren të bëjnë dallimin mes gabimeve më pak të rëndësishme dhe atyre më shumë të rëndësishme, duke u mbështetur shpesh tek trajtimi racional i gabimeve nga zyrtarët e qendrave të votimit. Pritshmëri të tilla mund të jenë të arsyeshme në një mjedis që karakterizohet nga një frymë e përgjithshme besimi. Sidoqoftë, ka rrethana, ku një zgjedhësi mund të mos i lejohet të votojë në ditën e zgjedhjeve nga një zyrtar i qendrës së votimit, dhe, të mbetet kështu pa votuar për shkak të një gabimi të vetëm tipografik në listën e zgjedhësve që krijon mospërputhje ndërmjet të dhënave bazë dhe të dhënave përkatëse në dokumentin e identitetit të zgjedhësit. Për këtë arsye, gabimet e vogla mund të cenojnë besueshmërinë e listave të zgjedhësve.

Njëkohësisht, gabimet me pasoja të qarta në ditën e zgjedhjeve janë:

- ✎ **Mosshtimi i një regjistrimi**, e cila mund të sjellë si pasojë që zgjedhësi të mbetet pa votuar;
- ✎ **Mosfshirja e një regjistrimi**, e cila mund të sjellë si pasojë ngritjen e pretendimeve për "persona të vdekur" në listat e zgjedhësve dhe mund të ndikojë në përmbushjen e kërkesave për pjesëmarrje (sipas rastit);
- ✎ **Mostransferimi i një regjistrimi**, e cila mund të sjellë si pasojë që zgjedhësi të mos e gjejë emrin e tij/saj të shënuar në listën e zgjedhësve;
- ✎ **Mosbërja e një korrigjimi, shuarjeje ose rivendosjeje**, e cila mund të sjellë pasoja të ngjashme me ato më lart;
- ✎ **Futja e të dhënave të gabuara të hedhura gjatë shtimit ose transferimit të regjistrimeve** (p.sh.: shkrimi i emrave gabim, regjistrimi i zgjedhësve në qendrën e gabuar të votimit), që mund të çojë në mosushtimin e së drejtës për të votuar nëse zgjedhësit nuk mund të gjenden në listë, ose në krijimin e regjistrimeve të shumëfishta (shih më poshtë);

¹¹ Kjo ndodh, veçanërisht, kur shkronjat cirilike përkthehen në shkronja latine dhe anasjelltas. Në raste të tilla, në dokumente të ndryshme një person mund të ketë disa variante zyrtare të emrit të tij/saj.

- ✎ **Seleksionimi i regjistrimit të gabuar për korrigjim apo transferim**, që, gjithashtu, mund të sjellë si pasojë mosushtimin e së drejtës për të votuar të zgjedhësve, duke dëmtuar në këtë rast edhe më shumë se një zgjedhës; dhe
- ✎ **Fshirja e një regjistrimi të vlefshëm** (p.sh.: gjatë pastrimit të regjistrimeve të mundshme të shumëfishta ose duke seleksionuar regjistrimin e gabuar për ta fshirë), që sjell si pasojë mosushtimin prej zgjedhësit të së drejtës për të votuar.

Një tjetër lloj gabimi i mundshëm është *grupi i regjistrimeve të shumëfishta*, kur në regjistër ka më shumë se një regjistrim të të njëjtit zgjedhës. Nëse regjistrimet janë identike, ato janë *regjistrime të sakta të shumëfishta*. Më shumë probabilitet ka që të ketë *regjistrime të mundshme të shumëfishta*, grup regjistrimesh që ndryshojnë me një ose disa karaktere, ndoshta edhe nga disa fusha, të cilat, pas këqyrjes me kujdes, duket se i takojnë të njëjtit zgjedhës. Grupe të dhënash bazë të mundshme e të shumëfishta mund të hasen në një qendër të vetme votimi, ku ato mund të identifikohen duke i kontrolluar me sy, por mund të hasen edhe në listat e zgjedhësve në qendra të ndryshme votimi. Po kështu, një e dhënë bazë mund të gjendet në një qendër votimi të një njësie të qeverisjes vendore, ndërsa një tjetër e dhënë bazë mund të gjendet në një tjetër njësi të qeverisjes vendore.

Edhe në rastin më të thjeshtë të grupeve të të dhënave bazë të mundshme dhe të shumëfishta që dallohen me sy në listat e zgjedhësve të qendrave të votimit, duhet të bëhet një analizë e kujdesshme për të përcaktuar nëse të dhënat bazë të grupit i takojnë të njëjtit zgjedhës dhe për të identifikuar se cili regjistrim grupi është ai i sakti. Një analizë e tillë kërkon përfshirjen e autoriteteve që mbajnë regjistrin përkatës të zgjedhësve, regjistrin e popullsisë ose arkivat e gjendjes civile, duke qenë se ato janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave.

Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të jenë të kujdesshëm kur bëjnë vlerësimin e gabimeve të mundshme serioze në listat e zgjedhësve. Në përgjithësi, nuk është e mundur që situata të kuptohet plotësisht apo shkaku i mospërputhjes të analizohet aty për aty. Nëse, gjatë veprimtarive për vëzhgimin e zgjedhjeve, hasen të dhëna bazë që mungojnë ose të dhëna bazë të shumëfishta, vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të përpiqen të pyesin autoritetet si mendojnë ta trajtojnë këtë çështje, dhe më pas, të raportojnë për çështjen dhe si po trajtohet.

F. Mbyllja e regjistrave të zgjedhësve

Legjislacioni i disa shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së kërkon që regjistrimi i zgjedhësve të përfundojë brenda një afati të caktuar kohe para ditës së zgjedhjeve. Pas përfundimit të këtij afati, regjistri i zgjedhësve *mbyllet*. Pas kësaj kohe, nuk lejohen ndryshime të regjistrimeve. Shtete të tjera pjesëmarrëse të OSBE-së lejojnë ndryshime edhe në ditën e zgjedhjeve, në varësi të kushteve specifike.

Pas përfundimit të regjistrimit të zgjedhësve, shpeshherë, paralelisht me periudhën e parashikuar për këqyrje nga publiku (shih më poshtë), është e mundur që të shpallet

numri i zgjedhësve të regjistruar në të gjithë vendin nga njësia e qeverisjes vendore dhe nga qendra e votimit. Shpallja publikisht e shifrave lidhur me regjistrimin e zgjedhësve përpara ditës së zgjedhjeve është e dobishme për kandidatët që marrin pjesë në zgjedhje dhe rrit transparencën e përgjithshme të procesit zgjedhor.

Mbyllja e regjistrimit të zgjedhësve i jep kohë punonjësve të regjistrimit të analizojnë sugjerimet e bëra nga zgjedhësit dhe punonjësit për ndryshime në listat paraprake të zgjedhësve. Më pas, ndryshimet përkatëse hidhen në listat paraprake të zgjedhësve, në mënyrë që të nxirren listat përfundimtare të zgjedhësve dhe të shpërndahen në qendrat e votimit në kohë.

Kur ndryshimet në listat e zgjedhësve lejohen afër ditës së zgjedhjeve ose në ditën e zgjedhjeve, kornizat legjislativ të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së parashikojnë, gjithashtu, afatin për pranimin e kërkesave për ndryshime, në mënyrë që punonjësit të kenë mundësi t'i nxjerrin në kohë listat përfundimtare të zgjedhësve. Gjithsesi, një legjislacion i tillë, u lejon prapëseprapë punonjësve të qendrave të votimit të bëjnë ndryshime në listat përfundimtare të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve në rast se një zgjedhës, i cili ka të drejtën e votës, paraqitet në një qendër votimi dhe i vërteton asaj qendre votimi se ai/ajo ka të drejtën e votës. E drejta e votës në këtë rast mund të vërtetohet duke paraqitur një dokument personal identiteti me adresën e zgjedhësit, një certifikatë të personit në rast të votimit në mungesë ose një vendim gjyqësor që përcakton të drejtën e zgjedhësit për të votuar.

Lista shitesë e zgjedhësve: Lista e përpiluar me shtesat e të dhënave bazë të zgjedhësve pas mbylljes së regjistrimit në prag të zgjedhjeve ose në ditën e zgjedhjeve quhet shpesh *lista shitesë e zgjedhësve*. Transparenca kërkon që numri i të dhënave bazë të listës shitesë të zgjedhësve të regjistrohet në procesverbalin e qendrës së votimit, në një kolonë më vete, në mënyrë që shifrat për numrin e zgjedhësve të regjistruar përpara dhe në ditën e zgjedhjeve të mund të vihen në dispozicion më vete. Në disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, ka një kërkesë të ligjit që, pas zgjedhjeve, listat e zgjedhësve në të gjithë vendin të verifikohen me mënyra krahasuese dhe të përcaktohet nëse mund të jetë abuzuar me listat shitesë të zgjedhësve për qëllime të votimit të shumëfishtë. Përfshirja e mundshme, pas zgjedhjeve, e të dhënave bazë të listave shitesë të zgjedhësve në regjistrat e zgjedhësve ose në regjistrat e popullsisë kërkon vëmendje të veçantë nga ana e punonjësve përkatës, meqenëse përfshirja e drejtpërdrejtë mund të ndikojë negativisht në saktësinë e regjistrimit të zgjedhësve.

G. Censusi dhe regjistrimi i popullsisë

Censusi jep një tablo të situatës demografike të një vendi, përfshirë dhe të popullsisë, familjeve, ekonomisë etj., në një moment të caktuar. Ndonëse censusi mund të sigurojë informacion të dobishëm për tendencat e zhvillimit nëse krahasohet me censuset e mëparshme, kjo tablo është e saktë vetëm në kohën kur kryhet censusi. Censuset kryhen në mënyrë periodike, zakonisht çdo dhjetë vjet. Në kontekstin e këtij manuali, termi census duhet kuptuar si numërim i popullsisë. Në vitet ndërmjet censuseve, ndryshimet

demografike mund të shpjegohen duke përdorur statistika ose informacione të marra nga regjistrimet e gjendjes civile ose regjistrat e popullsisë të përditësuara vazhdimisht.

Nga ana tjetër, *regjistrimi* i popullsisë duhet të konsiderohet si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme për të mbledhur dhe përditësuar rregullisht të dhënat personale për popullsinë për përdorim në të ardhmen. Regjistrimi i popullsisë bazohet në dokumente zyrtare dhe në përditësimin e rregullt të informacionit personal që grumbullohet sa herë që ndodh një ndryshim në gjendjen civile individuale si lindja, vdekja, marrja ose humbja e shtetësisë, martesja, shkurorëzimi ose ndryshimi i vendbanimit. Çdo praktikë regjistrimi kërkon planifikim të kujdesshëm se si duhet të regjistrohen ndryshimet në gjendjen civile, ku duhet të ruhen dokumentet origjinale, në të cilat regjistrohen ndryshimet në gjendjen civile, dhe cilat institucione duhet të informohen zyrtarisht për çdo ndryshim në gjendjen civile.

Duhet të vihen në dukje një sërë ndryshimesh midis censusit dhe *regjistrimit të popullsisë*:

Censusi

- Numëron të gjithë njerëzit që gjenden nga intervistuesit gjatë ditëve të bërjes së intervistave, por mund të lërë jashtë ata që nuk janë të pranishëm në vendin e tyre të banimit;
- Zakonisht, nuk përmban të dhëna personale; dhe
- Bazohet në vendbanimin aktual.

Regjistrimi i popullsisë:

- Kryhet gjatë një periudhe të zgjatur kohore dhe nuk regjistron jositetësit që banojnë në vend për një periudhë të shkurtër kohe;
- Grumbullon informacion të saktë personal, teorikisht, për të gjithë shtetasit e një vendi dhe duke respektuar në mënyrë strikte rregullat për mbrojtjen e të dhënave; dhe
- Bazohet në specifikime rigoroze, siç është adresa dhe/ose vendbanimi i regjistruar (i përhershëm ose i përkohshëm), siç përcaktohet zyrtarisht në legjislacionin e vendit.

Të dhënat e censusit mund t'i ndihmojnë vëzhguesit e zgjedhjeve të krijojnë një tablo të përafërt demografike për Shtetin përkatës. Ekziston mundësia që, sipas llogaritjeve statistikore bazuar në të dhënat e censusit, të bëhet një vlerësim i raportit të shtetasve që i përmbushin kriteret për të votuar me popullsinë e një njësie administrative dhe që ai të krahasohet me numrin zyrtar të zgjedhësve të regjistruar. Ky informacion mund të jetë i dobishëm për vëzhguesit e zgjedhjeve. Gjithsesi, krahasime të tilla duhet të trajtohen me kujdes për shkak të natyrës së ndryshme të praktikave dhe metodologjive që zbatohen për censusin dhe për regjistrimin e popullsisë.

Tipare të Përgjithshme të Sistemeve të Regjistrimit të Zgjedhësve

Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet, së pari, të identifikojnë veçoritë kryesore të sistemit të regjistrimit të zgjedhësve në vend, meqenëse sistemet e regjistrimit të zgjedhësve ndryshojnë ndjeshëm ndërmjet Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Informacioni në dispozicion të vëzhguesve për procesin e regjistrimit të zgjedhësve varet kryesisht nga formati i sistemit të regjistrimit të zgjedhësve, si dhe nga afati kohor i regjistrimit. Për të ndihmuar vëzhguesit e zgjedhjeve që të përcaktojnë një qasje ndaj vlerësimit të regjistrimit të zgjedhësve, në këtë kapitull jepen shpjegime për disa veçori kryesore të llojeve të ndryshme të sistemeve të regjistrimit të zgjedhësve dhe si duhet të bëhet dallimi ndërmjet tyre.

A. Regjistrimi aktiv dhe pasiv i zgjedhësve

Në *sistemet "aktive" të regjistrimit të zgjedhësve*, zgjedhësit duhet të marrin masa që, përpara çdo veprimtarie zgjedhore ose në mënyrë të vazhdueshme, të regjistrojnë pranë autoritetit përkatës synimin e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje. Kjo terminologji e vë theksin mbi faktin se përfshirja e emrit të zgjedhësit në listën e zgjedhësve është rezultat i vendimit të vetë zgjedhësve për t'u regjistruar. Për t'u regjistruar në një sistem të tillë, zgjedhësit duhet të plotësojnë formularë të posaçëm regjistrimi dhe t'ua paraqesin ato autoriteteve përkatëse brenda një afati të caktuar kohor ose, përndryshe, të ndërmarrin hapa konfirmues, në mënyrë që emrat e tyre të përfshihen në listën përkatëse të zgjedhësve.

Në *sistemet "pasive" të regjistrimit të zgjedhësve*, zgjedhësve nuk u kërkohet të ndërmarrin ndonjë veprim të posaçëm për t'u përfshirë në listat e zgjedhësve. Kjo terminologji e vë theksin tek regjistrimi automatik i zgjedhësve dhe tek përfshirja e tyre pa ndërmarrjen e ndonjë veprimi nga ana e vet. Në fakt, listat e zgjedhësve përpilohen mbi bazën e të dhënave ekzistuese, që mbahen dhe përditësohen nga autoritetet shtetërore ose bashkiake përkatëse. Në sistemin pasiv për regjistrimin e zgjedhësve, shpeshherë, të dhënat personale të zgjedhësve nxirren nga regjistrat e gjendjes civile, që mbahen nga autoritetet e qeverisjes vendore, zakonisht. Në këto raste, lloji i të dhënave burimore (p.sh.: regjistri i popullsisë, regjistrimet në gjendjen civile, regjistri i pasaportave, baza e të dhënave të identitetit) ndikon në cilësinë e regjistrimit të zgjedhësve.

Sistemet pasive mund të krijojnë perceptimin e gabuar se regjistrimi i zgjedhësve është plotësisht automatik dhe shtetasit nuk kanë asnjë rol në këtë praktikë. Megjithatë, nuk ndodh kështu, pasi, në këto sisteme, është shumë e rëndësishme që shtetasit t'i informojnë autoritetet në kohë për çdo ndryshim në të dhënat e tyre personale ose të vendbanimit të tyre.

B. Regjistrimi i vazhdueshëm dhe periodik i zgjedhësve

Sistemet administrative për regjistrimin e zgjedhësve, nganjëherë, cilësohen si të *vazhdueshme ose periodike*. Në *sistemin e vazhdueshëm*, regjistrat përditësohen rregullisht dhe vazhdimisht, sa herë që ndodh një ndryshim në gjendjen civile vetjake. Zgjedhësit mund t'i informojnë autoritetet në çdo kohë për ndryshimet në informacionin e tyre si zgjedhës, zakonisht duke kontaktuar një zyrë administrative. Është e rëndësishme që sistemi i njoftimit të funksionojë në mënyrë efektive ndërmjet autoriteteve të ndryshme publike të përfshira në proces. Shpeshherë, sistemet pasive janë të vazhdueshme.

Në *sistemet periodike*, regjistrimet përditësohen në mënyrë periodike ose përgatiten nga fillimi përpara një veprimtarie zgjedhore ose një herë në disa vjet. Në rrethana të jashtëzakonshme, si në situatat pas konflikteve, termi *periodik* mund të tregojë edhe fillimin nga e para të një praktike regjistrimi, kur në një regjistër të ri shtohen zgjedhës që i përmbushin kriteret për të votuar. Në një numër Shtetesh pjesëmarrëse të OSBE-së, legjislacioni përcakton një interval të caktuar kohor në secilin vit, kur shtetasit nxiten që t'i raportojnë ndryshimet në statusin e tyre si zgjedhës, veçanërisht ndryshimet sa i takon vendbanimit dhe fitimit apo humbjes së të drejtës për të votuar. Megjithëse, më së shumti, sistemet aktive janë periodike, nganjëherë, ato mund të jenë të vazhdueshme, në vende, ku zyrat administrative janë gjithnjë të hapura për të pranuar kërkesa të reja ose të përditësuara për regjistrim. Në disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, autoritetet mund të zgjedhin ta përditësojnë regjistrimin e zgjedhësve, duke përdorur sistemin periodik në prag të zgjedhjeve. Një përpyetje e tillë mund të mbështetet në fushatat derë më derë për regjistrimin e zgjedhësve ose përcaktimin e vendeve të posaçme të regjistrimit për pranimin e kërkesave që bëjnë zgjedhës individualë. Në raste të tilla, vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të vlerësojnë nëse këto fushata garantojnë shtrirje të mjaftueshme dhe lehtësi për përdorimin e formularëve të regjistrimit dhe për mbërritjen në vendet e regjistrimit.

C. Regjistrat në letër dhe regjistrat elektronikë

Regjistrat e gjendjes civile dhe të zgjedhësve mund të jenë në letër ose në format elektronik. Ndonëse procesi i regjistrimit të saktë të zgjedhësve mund të kryhet më së miri me një regjistër të plotë, elektronik, kjo gjë mund të mos jetë e mundur në disa vende. Regjistrat dhe listat fizike (në letër) të zgjedhësve në letër të zgjedhësve nuk ofrojnë të njëjtat masa mbrojtëse, pasi ata nuk janë lehtësisht të krahasueshëm, sa u takon të dhënave bazë të shumëfishta dhe janë më të vështirë për t'u përditësuar.

Regjistrat elektronikë të gjendjes civile ose të zgjedhësve mund të centralizohen dhe organizohen nga një bashki apo njësi tjetër administrative, ose regjistrat e bashkive mund të lidhen në rrjet në të gjithë vendin, në mënyrë që të mundësohen shërbimet përmes internetit, përfshirë dhe verifikimet me mënyra krahasuese të regjistrimeve të mundshme të shumëfishta. Në rastin e bazave të të dhënave të lidhura në rrjet, është e rëndësishme të bëhet kujdes që programet kompjuterike që përdorin njësi të ndryshme administrative të jenë të pajtueshme mes tyre. Në sistemet pasive për regjistrimin e zgjedhësve, ekziston mundësia që regjistri përkatës i zgjedhësve dhe/ose listat e zgjedhësve të qendrave të votimit, si ato paraprake, ashtu dhe ato përfundimtare, të nxirren nga regjistri elektronik i popullsisë sa herë që organizohen zgjedhje. Sistemet aktive, gjithashtu, mund të përfitojnë nga regjistrat elektronikë, pasi ato mund të përditësohen lehtësisht dhe të verifikohen për mungesë ose përsëritje të të dhënave bazë. Hyrja e zgjedhësve përmes internetit në regjistrimet e tyre lehtëson më tej regjistrimin e saktë të zgjedhësve, por ajo duhet rregulluar që të garantohen mbrojtja e të dhënave dhe masa të mjaftueshme mbrojtëse. Në disa vende, punonjësit e qendrave të votimit i verifikojnë listat e zgjedhësve në kompjuter, duke përshpejtuar kështu procesin e votimit.

D. Përgjegjësia administrative për regjistrimin e zgjedhësve

Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve mund të dallohet edhe nga organi administrativ përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e tij. Rregulloret e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së për regjistrimin e zgjedhësve ndryshojnë ndjeshëm dhe në aspekte të ndryshme të procesit mund të përfshihen disa institucione të ndryshme, veçanërisht në sisteme ku të dhënat për regjistrimin e zgjedhësve përbëjnë një nëngrup të një tjetër baze të dhënash që mbahet nga shteti. Është e rëndësishme që, në kuadrin ligjor, të parashikohet një ndarje e qartë e përgjegjësisë ndërmjet institucioneve dhe individëve të përfshirë në regjistrimin e zgjedhësve. Këto organe administrative duhet të kenë edhe mjetet për komunikimin e të dhënave dhe për shkëmbimin sistematik të informacioneve të tjera. Përpilimi dhe mirëmbajtja e regjistrave të popullsisë dhe/ose të zgjedhësve dhe e listave të zgjedhësve konsiderohen përgjithësisht detyrë administrative dhe, për këtë arsye, është zakonisht detyrë e pushtetit ekzekutiv që kryhet përgjithësisht nga autoritetet e qeverisjes vendore. Në sistemet pasive të regjistrimit janë përgjithësisht punonjësit e qeverisjes vendore ata që mbajnë përgjegjësi për përpilimin dhe përditësimin e listave të zgjedhësve, të cilat, më pas, i përcillen administratës zgjedhore përpara një veprimtarie zgjedhore. Sidoqoftë, administrata zgjedhore mund të jetë në gjendje t'i rishikojë të dhënat e paraqitura e mund edhe të përfshihet në dhënien e vendimeve për ankimimet që kanë të bëjnë me listat e zgjedhësve në periudhën fill para zgjedhjeve.

Disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së ia ngarkojnë detyrën e përpilimit dhe/ose rishikimit të regjistrave të zgjedhësve dhe të listave paraprake të zgjedhësve administratës zgjedhore. Në sistemet aktive të regjistrimit që nuk janë të lidhura me baza të dhënash apo veprimtari të tjera shtetërore, ka më shumë gjasa që të jetë administrata zgjedhore ajo që merr përsipër përgjegjësinë për regjistrimin e zgjedhësve. Në raste të tilla, legjislati i detyron administratën zgjedhore të krijojë qendra të përkohshme regjistrimi në nivel

vendor, përpara një lloj të caktuar zgjedhesh ose si pjesë të përhershme të strukturës organizative. Në raste të tjera, legjislati mund të kërkojë që kërkesat për regjistrim të pranohen nga agjenci të tjera shtetërore, të cilat i ofrojnë shërbime publikut dhe, më pas, t'ia kalojnë ato administratës zgjedhore për përpunim. Në vendet ku zgjedhjet administrohen nga një organ shtetëror ekzekutiv, siç është Ministria e Brendshme, ai organ mund të ketë edhe përgjegjësinë për regjistrin e popullsisë ose të zgjedhësve për të gjithë vendin. Ndër institucionet e tjera qendrore që mund të përfshihen në mënyrë domethënëse në përpilimin e regjistrave të zgjedhësve janë: Ministria e Drejtësisë, Policia e Shtetit ose instituti shtetëror i statistikave. Në rastet kur përfshihet më shumë se sa një institucion është e rëndësishme të përcaktohet se kush është përgjegjës për konsolidimin, përditësimin dhe rishikimin e të dhënave dhe në çfarë niveli. Në rastet kur institucione të ndryshme mund të kenë informacione kontradiktore për një individ, duhet të jetë e qartë se regjistrimet e cilit institucion duhet të kenë epërsi.

Në vende që marrin masa të posaçme për votimin e zgjedhësve që gjenden larg vendbanimeve të tyre, legjislati parashikon përfshirjen e agjencive të tjera në përpilimin e listave të zgjedhësve për qendra të veçanta votimi. Ndër to mund të përfshihen: Ministria e Punëve të Jashtme (për personelin e ambasadave dhe/ose për zgjedhësit që jetojnë jashtë vendit), Ministria e Mbrojtjes (për personelin ushtarak); Ministria e Brendshme (për forcat policore që mbajnë rendin në ditën e zgjedhjeve); Ministria e Drejtësisë (për të burgosurit dhe të ndaluarit); Ministria e Shëndetësisë (për të sëmurët në spitale dhe/ose personat në institucionet sociale); dhe autoritetet bregdetare (për ekuipazhet e anijeve).

Çështje për diskutim: Veçoritë e përgjithshme të sistemeve të regjistrimit të zgjedhësve

Përcaktoni nëse:

- Sistemi i regjistrimit është aktiv apo pasiv;
- Sistemi i regjistrimit është periodik apo i vazhdueshëm;
- Regjistri i zgjedhësve mbahet në letër apo në format elektronik;
- Regjistrimet elektronike mbahen në sisteme të veçuara të qeverisjes vendore apo në një bazë të dhënash të lidhur në rrjet në të gjithë vendin;
- Regjistri i zgjedhësve është një regjistër i ndarë, i veçuar ose nxirret nga një regjistër tjetër, siç është regjistri i popullsisë;
- Regjistri i zgjedhësve përgatitet nga e para për çdo lloj të caktuar zgjedhesh apo është regjistër i përhershëm që përditësohet sistematikisht;
- Përgjegjësitë e ndryshme janë të përcaktuara qartë dhe punonjësit e kuptojnë se “çfarë pune bën secilin”; dhe
- Të dhënat për regjistrimin e zgjedhësve përpilohen dhe mbahen nga autoritetet e qeverisjes vendore, administrata zgjedhore, agjenci të tjera shtetërore apo nga disa institucione bashkë.

Kuadri ligjor për regjistrimin e zgjedhësve

Hapi i parë që vëzhguesit dhe ekspertët e zgjedhjeve ndërmarrin për të kuptuar sistemin e regjistrimit të zgjedhësve është analiza e ligjeve dhe e rregulloreve përkatëse. Në këtë kapitull jepen disa orientime për mënyrën e vlerësimit të kuadrit ligjor për regjistrimin e zgjedhësve.¹² Ky vlerësim duhet bërë sa më herët që të jetë e mundur, meqenëse ai siguron informacion lidhur me planet e MVZ-ve për ndjekjen e procesit të regjistrimit të zgjedhësve.

A. Fusha e vlerësimit ligjor

Legjislati, i cili përcakton të drejtën për të votuar dhe regjistrimin e zgjedhësve, ndryshon ndjeshëm nga një vend i rajonit të OSBE-së te tjetri. Procedurat e regjistrimit të zgjedhësve janë të lidhura në mënyrë të pandashme me strukturën administrative të shtetit dhe traditën e tij kulturore sa i takon: (a) zhvillimit të zgjedhjeve; (b) identifikimit të shtetasve; (c) vendosjes së një lidhjeje të qartë dhe mjaftueshëm të kuptueshme midis identitetit personal dhe vendndodhjes ku zgjedhësi duhet të hedhë votën e tij/saj; dhe (d) privatësisë së të dhënave personale.

Analisti ligjor ka përgjegjësinë kryesore të analizimit të kuadrit ligjor, përfshirë edhe dispozitat për regjistrimin e zgjedhësve, ndërsa analisti i zgjedhjeve ka përgjegjësinë e ndjekjes së zbatimit të tij. Analisti ligjor duhet të jetë i përgatitur të analizojë një sërë ligjesh për të kuptuar plotësisht ndërlikimet e tyre për regjistrimin e zgjedhësve. Eksperti ligjor duhet të identifikojë cilat organe administrative janë përgjegjëse për përpilimin e regjistrave të zgjedhësve dhe listave të zgjedhësve, dhe të kërkojë nga institucionet përkatëse nxjerrjen e rregulloreve administrative. Në veçanti, analisti ligjor duhet të vlerësojë kërkesat sa i takon përmbushjes së kriterëve për të votuar, procedurat e përditësimit dhe rishikimit të listave të zgjedhësve, si dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, siç përcaktohet në kuadrin ligjor.

Një standard minimal, i cili duhet të përmbushë kuadri ligjor, është garantimi i të drejtës *universale* dhe të *barabartë* për të votuar. *Universal* do të thotë se çdo shtetas që përmbush kriteret për të votuar duhet t'i garantohet e drejta për të votuar, ndërsa e *barabartë* do të thotë se votat e të gjithë shtetasve që i përmbushin kriteret për të

¹² Shih, gjithashtu dokumentin e ODIHR-it "Manual për rishikimin e kornizave ligjore për zgjedhjet", i cili gjendet tek <http://www.osce.org/odihr/elections/13960>.

votuar kanë të njëjtën vlerë. Kuadri ligjor duhet, gjithashtu, të garantojë parimin e mosdiskriminimit në ushtrimin e të drejtës së votës.

Kuadri i përgjithshëm ligjor që rregullon regjistrimin e zgjedhësve mund të përfshijë:

- Dispozita kushtetuese;
- Dispozita të ligjit (ligjeve) për zgjedhjet që rregullojnë regjistrimin e zgjedhësve;
- Ligje të veçanta për regjistrimin e zgjedhësve;
- Ligje për regjistrimin e popullsisë ose regjistrimin në gjendjen civile, sipas rastit;
- Ligje të tjera siç janë ligjet për gjuhën ose shtetësinë; dhe
- Rregulla dhe rregullore administrative ku detajohen procedurat e zbatimit të dispozitave ligjore.

Kushtetuta e një shteti është dokumenti themeltar që përcakton shumicën e kohës në terma të përgjithshëm të drejtën e votës në bazë të moshës dhe shtetësisë. Neni 25 i PNDKP-së që përcakton standardin për respektimin e universalitetit thotë se “çdo shtetas ka të drejtën dhe mundësinë... të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirish” dhe “të votojë dhe të zgjidhet gjatë zgjedhjeve të qenësishme dhe periodike, duke ushtruar të drejtën universale dhe të barabartë të votës dhe në zgjedhje që mbahen me votim të fshehtë që garanton shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve”. Komenti i Përgjithshëm 25 thotë se “... Asnjë dallim nuk duhet lejuar ndërmjet shtetasve në gëzimin e këtyre të drejtave për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, bindjeve politike ose bindjeve të tjera, prejardhjes kombëtare ose shoqërore, pasurisë, statusit në lindje apo ndonjë statusi tjetër...”.

Në kushtetutë mund të përfshihen elemente të tjerë të sistemit të përfaqësimit dhe kriteret të përgjithshme për ndarjen administrative të vendit dhe për caktimin e zonave zgjedhore. Disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së i lejojnë joshitetasit të marrin pjesë në zgjedhjet vendore. Dispozita të tilla mund të kenë ndikim në procedurat e regjistrimit të zgjedhësve. Dispozitat që lidhen me regjistrimin e zgjedhësve parashikohen shpesh në legjisllacionin për zgjedhjet. Sidoqoftë, disa Shtete pjesëmarrëse kanë ligje të veçanta për regjistrimin e zgjedhësve. Në sistemet federale, dispozitat ligjore që lidhen me regjistrimin e zgjedhësve mund të jenë pjesë e legjisllacionit të shteteve federale ose njësive administrative vendore. Në disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, regjistrat e zgjedhësve dhe listat e zgjedhësve janë të lidhur drejtpërdrejt me regjistrat e popullsisë dhe me legjisllacionin përkatës. Në disa vende, ligjet mbi gjuhën, gjithashtu, mund të kenë ndikim në të drejtën e një personi për të marrë shtetësinë dhe në të drejtat e pakicave kombëtare për të pasur mundësi të marrin informacion për zgjedhësit në gjuhën e tyre.

Edhe rregulloret administrative që nxjerr administrata përgjegjëse për regjistrimin e zgjedhësve janë pjesë e rëndësishme e kuadrit ligjor, duke qenë se, teorikisht, ato i përshkruajnë procedurat e regjistrimit në të gjitha hollësitë e nevojshme. Gjithsesi, nuk duhet lejuar që kërkesat administrative ta kufizojnë të drejtën e votës.

B. Përbushja e kritereve për të votuar

Ndonëse e drejta universale e votës nënkupton se çdo person duhet të lejohet të votojë, kriteret të caktuara të së drejtës së votës pranohen përgjithësisht nga standarde ndërkombëtare. Kriteret përgjithësisht të pranuar për të drejtën e votës përfshijnë: shtetësinë, moshën e lejuar për të votuar, vendbanimin dhe mungesën e rrethanave skualifikuese, siç përcaktohen në ligj dhe në vendime gjyqësore. E drejta e personave për të kandiduar për një funksion publik lidhet, zakonisht, me të drejtën e votës. Analisti ligjor duhet të identifikojë dhe të shqyrtojë me kujdes kriteret, që duhet të përmbushin zgjedhësit për të votuar, përfshirë dhe shkaqet për skualifikim.

1. Shtetësia

Shtetësia është përgjithësisht kriteri kryesor për të pasur të drejtën e votës ose të kandidimit për një funksion publik në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Në disa Shtete pjesëmarrëse, shtetasve të natyralizuar u jepet e drejta e votës, por nuk u lejohet të zgjidhen në funksionet më të larta të shtetit. Shtetasit me dy shtetësi kanë përgjithësisht të drejtën e votës dhe të kandidimit për poste publike, ndonëse disa shtete ua kufizojnë të drejtën e kandidimit për poste publike. Përcaktimi i shtetësisë konsiderohet përgjithësisht e drejtë sovrane e çdo Shteti pjesëmarrës të OSBE-së.¹³ Çështjet e shtetësisë rrallëherë shqyrtohen në mënyrë të hollësishme brenda fushës së veprimtarive të ODHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Megjithatë, duke qenë se ligjet për shtetësinë dhe natyralizimin prekin të drejtën e votës apo të kandidimit për funksion publike, është e rëndësishme të kuptohet se si i nxit apo frenon ky legjislacion njerëzit, përfshirë edhe anëtarët e pakicave kombëtare, për t'u bërë shtetas dhe pjesëmarrës me të drejta të plota në jetën publike.

Në praktikë, në Shtetet pjesëmarrëse ku regjistrat e zgjedhësve nxirren nga regjistrat e popullsisë, është me vlerë që vëzhguesit ta kuptojnë procesin se si dallohet një shtetas nga një josh tetas, në mënyrë që në regjistrin e zgjedhësve ose në listat e zgjedhësve për zgjedhje të caktuara të përfshihen vetëm ata që kanë të drejtën e votës. Kjo, për shembull, bëhet e rëndësishme kur kriteret për të drejtën e votës ndryshojnë nga një periudhë zgjedhjesh në tjetrën. Në vendet anëtare të BE-së, shtetasit me vendbanim në shtete të tjera anëtare të BE-së kanë të drejtën e votës dhe të kandidimit për funksione publike

¹³ Vendimi gjyqësor i GJEDNJ-së "Tanasa dhe Chirtoaca kundër Moldavisë". Në raste të kufizimit për shkak të shtetësisë, kjo përbën shkelje të së drejtës për t'u zgjedhur; shih : <http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/view.asp?item=2&portal=hbkm-&action=html&highlight=Tanasa&sessionid=95467604&skin=hudoc-en>.

në zgjedhjet për Parlamentin Evropian¹⁴ dhe në zgjedhjet vendore,¹⁵ por zakonisht përjashtohen nga pjesëmarrja në zgjedhjet kombëtare. Disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së u lejojnë josh tetas të tjerë, ligjërisht me banim në vendin ku mbahen zgjedhjet, të marrin pjesë në zgjedhje vendore. Në disa shtete, ligji kërkon që josh tetaset, të cilët kanë dëshirë të votojnë në këto zgjedhje, të bëjnë kërkesë në mënyrë individuale që të shtohen në listën e zgjedhësve. Në shtete të tjera, përfshirja në regjistrin e zgjedhësve për ato zgjedhje mund të jetë “automatike”, bazuar në të dhënat e tjera që mbahen nga shteti.

2. Kërkesat lidhur me moshën

Vendosja e kufirit të një moshe minimale sa i takon të drejtës së votës është universale për Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Përgjithësisht, mosha minimale lidhet me moshën madhore të përcaktuar me ligj në vendin përkatës. Në shumicën e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, mosha minimale për të votuar shkon nga 18 deri në 21 vjeç. Ka edhe raste ku mosha e lejuar për të votuar varion sipas llojit të zgjedhjeve. Legjislacioni ndryshon sa i takon datës brenda së cilës zgjedhësi duhet të arrijë moshën e lejuar për të votuar. Në shumicën e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, kërkohet që mosha e lejuar për të votuar të jetë arritur deri në datën e zgjedhjeve, në të cilat personi ka dëshirë të votojë. Një qasje e tillë nxit ushtrimin e së drejtës së votës. Gjithsesi, në shtete të tjera, personi duhet ta ketë arritur moshën e lejuar për të votuar para mbylljes së periudhës së regjistrimit të zgjedhësve. Në sistemet pasive të regjistrimit të zgjedhësve, zgjedhësit që votojnë për herë të parë duhet të përfshihen automatikisht në regjistrat e zgjedhësve dhe në listat e zgjedhësve. Në sistemet aktive, zgjedhësit që votojnë për herë të parë duhet të ndjekin procedurat administrative për t'u regjistruar si votues. Në këto raste, partitë politike zhvillojnë shpeshherë fushata informuese për të inkurajuar regjistrimin e zgjedhësve. Analisti i zgjedhjeve duhet të verifikojë nëse zgjedhësit e rinj janë shtuar në listat e zgjedhësve sipas procedurave të vendosura.

3. Kërkesat lidhur me vendbanimin

Kriteret e vendbanimit e lidhin të drejtën e votës me pasjen e një vendbanimi të regjistruar për një periudhë të caktuar kohe para ditës së zgjedhjeve ose deri në një moment të caktuar. Kriteret e tilla mund ta bëjnë regjistrimin edhe më të ndërlikuar, veçanërisht sa u takon zgjedhjeve për qeverisjen vendore apo zgjedhjeve parlamentare me sisteme mazhoritare votimi që kanë si kusht që zgjedhësi të ketë qenë me vendbanim në një zonë të caktuar që të ketë të drejtën e votës në atë zonë. Për zgjedhje të ndryshme mund të kërkohen periudha të ndryshme vendbanimi. Kërkesat e vendbanimit prekin shpesh zgjedhësit që e kanë ndryshuar vendbanimin afër datës së zgjedhjeve. Në disa Shtete pjesëmarrëse, zgjedhësit që nuk përmbushin kriteret për të votuar në zonën zgjedhore të vendbanimit të tyre të ri mundet prapëseprapë të votojnë në zonën zgjedhore të vendbanimit të tyre të mëparshëm. Shpeshherë, kërkesat lidhur me vendbanimin, sa i

14 Direktiva 93/109/KE e Këshillit, datë 6 dhjetor 1993; shih : http://eur-lex.europa.eu/smartapi/cgi/sga_doc?smartapi!celexapi!prod!CELEXnumdoc&lg=EN&numdoc=31993L0109&model=guichett.

15 Direktiva 94/80/KE e Këshillit, datë 19 dhjetor 1994; shih: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31994L0080:en:NOT>. Shih, gjithashtu, Kartën e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, Titulli V – “Të drejtat e shtetasve”, neni 40, gjendet tek: www.europarl.europa.eu/charter.

takon kandidimit për funksione publike, janë më afatgjata se ato që lidhen me votimin. Ka disa Shtete pjesëmarrëse, të cilat i lejojnë zgjedhësit me të drejtë vote të votojnë në çfarëdo lloji qendre votimi të zonës zgjedhore përkatëse. Procedura të tilla mund të shoqërohen me masa mbrojtëse shtesë, siç është ngjyerja e gishtave të dorës me bojë ose vulosja e dokumenteve të identitetit të zgjedhësve pas hedhjes së votës. Të tilla masa mbrojtëse mund të mos merren nëse regjistri i zgjedhësve i zonës zgjedhore është elektronik dhe listat e zgjedhësve të qendrave të votimit janë të lidhura në rrjet. Në raste të tilla, të gjitha qendrat e votimit brenda një zone zgjedhore mund të verifikojnë nëse zgjedhësit e kanë hedhur tashmë votën dhe, kështu, të parandalojnë përpjekje të mundshme për të votuar shumë herë. Në disa Shtete pjesëmarrëse, zgjedhësit që banojnë dhe regjistrohen për të votuar jashtë vendit, votojnë në zonën zgjedhore ku janë regjistruar përpara transferimit jashtë vendit.

4. Pezullimi i të drejtës së votës

Standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtën universale të votës e kufizojnë heqjen e së drejtës së votës në dy shkaqe: vendimi gjyqësor se personi është i paaftë mendërisht ose dënimi për një krim të rëndë. Në Komentin e Përgjithshëm 25, standardet që përcaktohen në nenin 25 të PNDKP-së shtjellohen si më poshtë:

“... shkaqet për këtë heqje duhet të jenë objektive dhe të arsyeshme. Në rast se dënimi për një vepër penale përbën bazën e pezullimit të së drejtës së votës, periudha e këtij pezullimi duhet të jetë në raport të drejtë me veprën penale dhe me masën e dënimit. Personat, të cilëve iu është hequr liria, por që nuk janë dënuar, nuk duhet të përjashtohen nga ushtrimi i të drejtës për të votuar...”

Përveç kësaj, në paragrafin 24 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990, kërkohet që “Çdo kufizim i të drejtave dhe lirive në shoqëri demokratike duhet të lidhet me njërin prej objektivave të legjislacionit në fuqi dhe të jetë thjesht në raport të drejtë me qëllimin e atij legjislacioni.”

Ka ende disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së ku, përveç të burgosurve, ish-të burgosurve që e kanë vuajtur masën e dënimit dhe të ndaluarve aktualë iu hiqet e drejta e votës. Analisti ligjor duhet të analizojë me kujdes çdo procedurë të Shtetit pjesëmarrës për pezullimin e të drejtës së votës, përfshirë dhe procesin e rishikimit të një vendimi të tillë. Për më tepër, analisti i zgjedhjeve duhet të vlerësojë si organizohen në praktikë pezullimi dhe rivendosija e regjistrimeve dhe e të dhënave bazë, me qëllim identifikimin e çdo mundësie të heqjes së padrejtë të së drejtës së votës.¹⁶

Standardet ndërkombëtare dhe praktika e mirë tregojnë se heqja e të drejtës së votës duhet t’i nënshtrohet disa kufizimeve. Këtu futen disa kriteret, sipas të cilave:

¹⁶ Shih vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së për çështjet gjyqësore “Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar” dhe “Frodl kundër Austrisë”.

- ☞ Kufizimet e të drejtës së votës duhet të përkufizohen me shkrim në ligj;
- ☞ Duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit të sanksionit me veprën penale; dhe
- ☞ Paaftësia mendore mund të përcaktohet vetëm me vendim gjykatë¹⁷

C. Kërkesa për përditësime të informacionit në regjistrin e zgjedhësve dhe të të dhënave bazë në listat e zgjedhësve

Në kuadrin ligjor duhet të përcaktohet qartë kush lejohet të bëjë kërkesë për përditësime të informacionit dhe/ose të dhënave bazë të regjistrimit, procedura për bërjen e kërkesave të tilla, si dhe afatet për bërjen e kërkesave të tilla. Në sistemet e regjistrimit të vazhdueshëm të zgjedhësve, zgjedhësit duhet të kenë mundësi t'i kërkojnë rregullisht përditësime zyrës së autoriteteve që mbajnë të dhënat e regjistrimit. Këto kërkesa nuk duhet të kufizohen në periudhën kohore në prag të zgjedhjeve të caktuara, sidomos kur kjo nevojitet për të finalizuar regjistrat përpara ditës së zgjedhjeve. Në disa shtete, njerëzve u lejohet të bëjnë kërkesa që prekin persona të tjerë. Kërkesa të tilla duhet të lejohen vetëm me kusht që personi i prekur të njoftohet lidhur me kërkesën dhe që ati t'i jepet mundësia e reagimit. Sidoqoftë, kuadri ligjor duhet t'i bëjë të qarta procedurat specifike për kërkesa të tilla për të mos lejuar në asnjë rast heqjen e mundshme të së drejtës së votës zgjedhësve që e kanë këtë të drejtë.

Kur përditësimet mund të kërkohen nga persona të tretë, përveçse nga vetë zgjedhësi, siç janë partitë politike, kandidatët apo palët e tjera të interesuara, kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë:

- ☞ Individët dhe grupet që e kanë të drejtën të bëjnë kërkesa të tilla;
- ☞ Procedura për bërjen e kërkesës;
- ☞ Dokumentet që duhen paraqitur në mbështetje të kërkesës;
- ☞ Procedurat e njoftimit të zgjedhësit të prekur nga përditësimi/ndryshimi;
- ☞ E drejta e zgjedhësit të prekur për të qenë i pranishëm ose, në rast të kundërt, për të reaguar;
- ☞ Afati i paraqitjes dhe përpunimit të këtyre kërkesave;
- ☞ Procesi i rishikimit me anë të të cilit vendoset nëse pranohet apo jo kërkesa;
- ☞ Mënyrat e njoftimit të zgjedhësit për vendimin administrativ;
- ☞ E drejta e zgjedhësit për ta ankimuar në gjykatë vendimin administrativ; dhe
- ☞ Institucioni që merr vendimin e formës së prerë.

Në kuadrin ligjor duhet të parashikohet që vendimet sa i takon kërkesave të merren në mënyrë të përsheptuar, brenda afatit kohor të përcaktuar në mënyrë specifike në ligj.

¹⁷ Shih paragrafin 24 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990. Shih, gjithashtu, Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias.

Të gjitha vendimet duhet të jenë objekt i apelimit gjyqësor dhe gjykatat duhet të marrin vendim me shpejtësi për ankimime të tilla, brenda periudhës kohore të përcaktuar në mënyrë specifike në ligj. Gjithashtu, në kuadrin ligjor duhet të parashikohet një periudhë për këqyrjen nga publiku (shih më poshtë), në mënyrë që të rishikohen përditësimet e bëra që nga zgjedhjet e mëparshme.

D. Mbrojtja e të dhënave personale

Analisti ligjor duhet të vlerësojë me kujdes dispozitat që përcaktojnë se çfarë informacioni dhe çfarë të dhënash personale hidhen publikisht në regjistra për zgjedhësit dhe se për çfarë qëllimesh do të përdoren këto informacione dhe të dhëna nga aktorët e ndryshëm në zgjedhje. Një nga sfidat lidhur me dhënien akses partive politike, grupeve civile apo individëve, përveçse vetë zgjedhësve, në regjistrat e zgjedhësve dhe në listat e zgjedhësve qëndron tek gjetja e ekuilibrit të duhur midis mbrojtjes së të dhënave personale dhe shkallës së arsyeshme të bërjes së tyre publike.¹⁸ Përgjithësisht, publik duhet të bëhet vetëm informacioni që nevojitet për identifikimin e zgjedhësit me të drejtë vote në zgjedhje të caktuara, veçanërisht kur regjistri i zgjedhësve nxirret nga regjistri i popullsisë, i cili përfshin më shumë të dhëna personale. Standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale parashikojnë garanci të posaçme kur të dhënat përpunohen ose ruhen. Informacioni për zgjedhësit duhet të jetë i saktë, i përditësuar dhe jo i ekzagjeruar për qëllimet për të cilat ai ruhet. Ka gjithashtu edhe detyrime për t'i siguruar këto të dhëna nga shkatërrimi ose humbja aksidentale, si dhe nga akses, ndryshimi apo përhapja e paautorizuar e tyre.¹⁹

Kuadri ligjor duhet të shprehet qartë lidhur me përdorimin e lejuar të informacionit të përfutur nga kontrolli i regjistrave të zgjedhësve dhe nëse ky informacion mund të përdoret për qëllime të tjera, përveçse për të kërkuar korrigjime apo për të ngritur kundërshti në lidhje me regjistrimin e zgjedhësve. Në veçanti, legjislacioni duhet të shprehet nëse informacioni mund të përdoret për veprimtari të fushatave të partive

18 Në dokumentin e OSBE/ODIHR-it "Angazhimet ekzistuese për zgjedhje demokratike në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së" thuhet se "Listat e zgjedhësve duhet të jenë aktuale, të sakta, të plota, lehtësisht të aksesueshme për këqyrje nga zgjedhës të kualifikuar dhe – duke iu nënshtruar mbrojtjes së informacionit personal – ndoshta edhe nga të tjerë (siç janë kandidatët në zgjedhje dhe punonjësit shkencorë) që kanë një arsye të ligjshme për të hyrë në to... Pavarësisht sistemit të përdorur për krijimin dhe mbajtjen e listës së zgjedhësve, është e domosdoshme që ky sistem të jetë transparent dhe i hapur për verifikim nga zgjedhësit, kandidatët politikë dhe vëzhguesit e zgjedhjeve. Megjithëse ka çështje të rëndësishme që duhen marrë parasysh sa i takon privatësisë, të cilat mund të shihen ndryshe nga vende të ndryshme, duhet të sigurohet aksesimi me qëllim veprimet verifikueset. Në shumë vende, kandidatëve politikë dhe vëzhguesve të zgjedhjeve u lejohej jo vetëm t'i kqyrin listat e zgjedhësve, por edhe të marrin kopje të tyre" (shih: <http://www.osce.org/odihr/elections/13957>, f. 62).

19 Këshilli i Evropës, Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, Strasburg, 28.01.1981, Seria e Traktateve Evropiane – nr. 108, veçanërisht nenet 3, 5 dhe 7 (<http://conventions.coe.int/treaty/en/treaties/html/108.htm>). Shih, gjithashtu, Protokollin Shtesë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, sa i takon Autoriteteve Mbikëqyrëse dhe qarkullimit ndërkufitar të të dhënave personale, 08.11.2001, Seria e Traktateve Evropiane – nr. 181 (<http://conventions.coe.int/treaty/en/treaties/html/181.htm>), si dhe Direktivën 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 24 tetorit 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, si dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31995L0046:en:HTML>).

politike dhe kandidatëve. Gjithashtu, legjislati duhet të përcaktojë sanksionet në rastet e keqpërdorimit të informacionit të përfutur nga regjistrat e zgjedhësve.²⁰

Pyetje për diskutim: Kuadri ligjor për regjistrimin e zgjedhësve

- Cilat ligje kanë rëndësi për regjistrimin e zgjedhësve?

- Në cilat rregullore administrative jepen sqarime për zbatimin e kuadrit legjislativ dhe a mund t'i vihen këto rregullore në dispozicion MVZ-së?

- A merren vendimet me shpejtësi brenda afateve të përcaktuara specifiku në ligj?

- A i respekton përgjithësisht kuadri ligjor parimet e të drejtës universale dhe të barabartë të votës?

- A parashikohen qartë në legjislati kriteret për të drejtën e votës dhe a janë këto kriteret të arsyeshme dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare?

- A ka dispozita ligjore që mund të vënë në pikëpyetje regjistrimin e zgjedhësve nga grupe specifike si pakicat, gratë, të varfrit apo personat analfabetë ose të zhvendosur?

- A parashikon legjislati regjistrimin e të ndaluarve, të burgosurve apo të ish- të burgosurve që e kanë kryer dënimin?

- A janë shkaqet e parashikuara për heqjen e të drejtës së votës të arsyeshme dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare gjerësisht të pranuar?

- A përcakton qartë kuadri ligjor se kush mund të kërkojë përditësime të regjistrave të zgjedhësve dhe/ose listave të zgjedhësve dhe kujt mund t'i drejtohen këto kërkesa?

- A ofron legjislati mbrojtje të të drejtave të zgjedhësve, regjistrimi i të cilëve vihet në pikëpyetje?

- A ekziston një proces të unifikuar ankimimi sa i takon përditësimeve të regjistrave dhe/ose listave të zgjedhësve?

- A përcaktohet qartë në kuadri ligjor se çfarë informacioni personal duhet të bëhet publik, qëllimet për të cilat mund të përdoret ai dhe masat ndëshkimore për keqpërdorimin e tij?

- A është përcaktuar dhe parashikuar me ligj periudha për këqyrje nga publiku?

²⁰ Shih, gjithashtu, Udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për Rregullimin e Dosjeve Elektronike të të Dhënave Personale, i cili gjendet tek: <http://daccess-dds.ny.un.org/doc/RESOLUTION/GEN/NR0/564/84/IMG/NR056484.pdf?OpenElement>.

Vlerësimi i Transparencës

Po aq e rëndësishme sa cilësia e kuadrit ligjor që rregullon regjistrimin e zgjedhësve është edhe efikasiteti i zbatimit të tij. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet ta vlerësojnë zbatimin e procesit të regjistrimit të zgjedhësve duke u nisur nga transparencja, saktësia dhe gjithëpërfshirja e tij. Ky kapitull trajton se si mund ta vlerësojnë vëzhguesit transparencën e procesit të regjistrimit të zgjedhësve.

A. Rreth transparencës

Proceset transparente të regjistrimit të zgjedhësve janë element kyç për garantimin e besimit të publikut. Prandaj, transparencja përbën një çështje e rëndësishme për t'u shqyrtuar nga vëzhguesit. Proceset transparente të regjistrimit të zgjedhësve i japin publikut akses në regjistrin dhe listat e zgjedhësve për t'i rishikuar përpara ditës së zgjedhjeve. Përveç kësaj, ky proces bën të mundur që partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile të vëzhgojnë fazat e ndryshme të procesit të regjistrimit të zgjedhësve. Në vendet ku publikut nuk i lejohet ose pengohet të hyjë në regjistrin dhe listat e zgjedhësve, pretendimet për pasaktësi apo për përpjekje për manipulim të listave të zgjedhësve mund ta dobësojnë besimin e publikut te paprekshmëria e regjistrit të zgjedhësve dhe e procesit zgjedhor në tërësi. Nga ana tjetër, në vende ku zgjedhësit dhe palët e interesuara në zgjedhje lejohen t'i kontrollojnë dhe t'i verifikojnë listat e zgjedhësve përpara ditës së zgjedhjeve, shkalla e besimit të publikut te integriteti i tyre dhe cilësia e regjistrit përfundimtar të zgjedhësve përgjithësisht rritet.

Përgjithësisht, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile janë shumë të interesuara t'i vëzhgojnë fazat e ndryshme të regjistrimit të zgjedhësve, duke qenë se ky është një aspekt i ndjeshëm i procesit zgjedhor dhe burim i mundshëm mosbesimi mes aktorëve në zgjedhje. Përpjekjet për një vëzhgim të tillë mund të ndihmojnë në rritjen e besimit të publikut tek regjistri i zgjedhësve dhe të evidentojnë fushat shqetësuese që duhen trajtuar. Analisti ligjor duhet të verifikojë nëse u jepet akses partive politike dhe grupeve të shoqërisë civile në procesin e regjistrimit të zgjedhësve, përfshirë dhe regjistrin e zgjedhësve dhe në dokumente të tjera përkatëse dhe çfarë lloj aksesi u jepet, si dhe të identifikojë çdo fushë ku nuk lejohet aksesi. Aksesi duhet të lejohet si gjatë mbajtjes sistematike të regjistrit të zgjedhësve ose regjistrit të popullsisë, ashtu edhe gjatë çdo veprimtarie të regjistrimi apo përditësimi përpara zgjedhjeve.

Megjithëse verifikimi nëse dispozitat ligjore u japin akses zgjedhësve dhe aktorëve zgjedhorë në procesin e regjistrimit të zgjedhësve është detyrë e analistit ligjor, kryerja

e një procesi transparent është një çështje shumë më e gjerë për t'u ndjekur dhe për t'u vlerësuar nga një MVZ. Ndonëse MVZ-të nuk ka shumë gjasa të jenë të pranishme në vendin ku do të mbahen zgjedhjet në fazën kur hartohet fillimisht regjistri i zgjedhësve (në rastet e sistemeve aktive të regjistrimit të zgjedhësve) apo kur bëhen përditësime të vazhdueshme të regjistrimit të popullsisë (në sistemet pasive të regjistrimit të zgjedhësve), vëzhguesit mundet, prapëseprapë, të grumbullojnë informacion dhe të vëzhgojnë fazën të rëndësishme të regjistrimit të zgjedhësve, të cilat pasqyrojnë transparencën e procesit në tërësi.

B. Periudha për këqyrje nga publiku

Në prag të zgjedhjeve, është praktikë e mirë që autoritetet t'i publikojnë listat paraprake të zgjedhësve dhe, për periudhën e parashikuar, t'i afishojnë ato për këqyrje nga publiku në vende të volitshme për zgjedhësit. Gjatë kësaj kohe, çdo zgjedhës që ka vënë re pasaktësi ose gabime në listat paraprake të zgjedhësve, ka mundësinë të informojë autoritetin përgjegjës dhe të kërkojë ndryshime. Autoritetet përgjegjëse shqyrtojnë kërkesat dhe, nëse këto mbështeten nga dëshmi siç e kërkon ligji, vazhdojnë me bërjen e ndryshimeve. Në ligj duhet të parashikohet një periudhë minimale, përpara zgjedhjeve, për këqyrje nga publiku. Cilado qoftë kjo periudhë kohore, e rëndësishme është që brenda saj të mund të bëhen ndryshimet përpara publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve.

Afatet e parashikuara me ligj për periudhën e këqyrjes nga publiku duhet të marrin në konsideratë sa më poshtë:

- Njoftimet lidhur me periudhën e këqyrjes nga publiku dhe afati i regjistrimit apo paraqitjes së kërkesave për ndryshime duhet të jenë të tilla që t'i japin publikut kohë të mjaftueshme për të reaguar;
- Periudha e këqyrjes nga publiku duhet të jetë e mjaftueshme si kohë që zgjedhësit dhe të tjerët të kenë mundësi t'i shqyrtojnë listat e zgjedhësve dhe të kërkojnë ndryshime;
- Duhet të ketë kohë të mjaftueshme nga përfundimi i periudhës së këqyrjes nga publiku deri në publikimin e listave përfundimtare të zgjedhësve për bërjen e ndryshimeve; dhe
- Duhet të ketë kohë të mjaftueshme për ankime në gjykatë për mosmarrje parasysh të kërkesave për ndryshime para publikimit të listave përfundimtare të zgjedhësve.

Është e rëndësishme që procesi i këqyrjes nga publiku të jetë i aksesueshëm për zgjedhësit, pasi është mundësia e tyre kryesore për t'u njohur me listat e zgjedhësve dhe për të identifikuar çdo problem. Pjesëmarrja e gjerë në këtë proces kontribuon në rritjen e besimit të publikut dhe të cilësisë së listave përfundimtare të zgjedhësve. Prandaj, publiku duhet të jetë i mirëinformuar për kohën dhe vendndodhjen e njësive ku publiku mund t'i këqyrë listat. Këto njësi duhet të jenë sa më afër vendndodhjes së zgjedhësve






që të jetë e mundur, në mënyrë që të mos u duhet të rrugë të gjatë dhe duhet të jenë të hapura në një orar që u mundëson pjesëmarrjen e një numri të madh zgjedhësish, përfshirë edhe ata që punojnë gjatë ditës. Gjatë periudhës së parashikuar për këqyrje nga publiku, edhe partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile duhet ta kenë mundësinë t'i kontrollojnë listat dhe të kundërshtojnë të dhëna bazë të caktuara. Një praktikë e mirë është që palëve të interesuara në zgjedhje t'u jepet regjistri i zgjedhësve në format elektronik, duke respektuar privatësinë dhe në pajtim me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave, në mënyrë që informacioni të mund të kërkohet me lehtësi. Autoritetet mund të shohin mundësinë e afishimit në internet të një varianti të shkarkueshëm të listës së zgjedhësve, pajisur me funksionin e kërkimit. Me bërjen e korrigjimeve, për efekt transparence, autoritetet duhet t'ua japin listat përfundimtare të zgjedhësve edhe partive politike dhe grupeve të shoqërisë civile. Duke qenë se periudha për këqyrje nga publiku shtrihet pikërisht para ditës së zgjedhjeve, ajo shpesh përkon me periudhën e mbërritjes së MVZ-së. Lidhur me transparencën e procesit të regjistrimit të zgjedhësve, VAGJ-të mund të grumbullojnë informacion të rëndësishëm gjatë periudhës së parashikuar për këqyrje nga publiku, duke biseduar me autoritetet vendore përgjegjëse dhe me palët e interesuara në zgjedhje, si dhe duke e vëzhguar procesin nga afër, kur është mundësia. Gjatë takimeve me autoritetet vendore, VAGJ-të duhet të pyesin sa ndryshime janë kërkuar, sa janë bërë, nëse ka pasur ankesa apo ankime, si dhe sa aktiv ka qenë publiku në kontrollimin e listave paraprake të zgjedhësve. Gjithashtu, është e rëndësishme të bëhen takime me përfaqësues të partive politike dhe të kandidatëve, si dhe me vëzhguesit vendas, në mënyrë që të merret informacion për pikëpamjet e tyre lidhur me procesin e këqyrjes nga publiku. Nëse ka pasur ndonjë apelim, VAGJ-të duhet të pyesin lidhur me natyrën e apeliemeve, procesin e shqyrtimit dhe rezultatet përfundimtare të rasteve. Edhe nëse burimet për vëzhgimin e procesit të këqyrjes nga publiku janë të kufizuara, është gjithsesi e dobishme që VAGJ-të të shkojnë të vizitojnë vendet ku zhvillohet procesi i këqyrjes nga publiku në zonën e vëzhgimit, të bëjnë pyetjet e siguruara nga MVZ-ja lidhur me zhvillimin e procesit dhe t'ia raportojnë rregullisht gjetjet e tyre MVZ-së. Vizitat në terren mund të ndihmojnë për të krijuar një tablo se si kryhet procesi i këqyrjes nga publiku, nëse procedurat ndiqen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë vendin dhe nëse ndeshen probleme të dukshme në njësitë e vizituara. Gjithashtu, këto vizita i ndihmojnë VAGJ-të ta kuptojnë më mirë procesin në mënyrë që të jenë të informuar kur diskutojnë me autoritetet vendore dhe me aktorët zgjedhorë.

C. Informimi i zgjedhësve

Për të ushtruar të drejtat e tyre civile dhe politike dhe për të përmbushur përgjegjësitë e tyre, palët e interesuara në zgjedhje duhet t'i kuptojnë plotësisht hapat e nevojshëm për të konfirmuar të drejtën e zgjedhësve për të votuar dhe të kandidatëve për të kandiduar, si dhe për të garantuar përfshirjen e zgjedhësve në listat e zgjedhësve. Në një proces transparent regjistrimit të zgjedhësve, edhe administrata përgjegjëse duhet të marrë masa për t'i dhënë publikut informacion të plotë dhe në kohë për procedurat në fjalë. Një MVZ duhet të përcaktojë se çfarë hapash kanë ndërmarrë organet administrative qendrore dhe vendore për t'i informuar zgjedhësit dhe aktorët e ndryshëm rreth procesit të regjistrimit të zgjedhësve dhe për të vlerësuar nëse zgjedhësit kanë informacion të mjaftueshëm rreth

procesit të këqyrjes nga publiku dhe veprimtarive të tjera të regjistrimit të zgjedhësve. Megjithatë është e vështirë të përcaktohet nëse publiku ka informacionin e duhur, vëzhguesit e zgjedhjeve mund të kërkojnë edhe opinionin e bashkëbiseduesve siç janë përfaqësuesit e shoqërisë civile, gazetarët dhe akademikët për këtë. Është praktikë e mirë që punonjësit publikë të përgatisin dhe të publikojnë gjerësisht materiale për informimin e zgjedhësve dhe të shpallin afatet e mbylljes së veprimtarive të regjistrimit të zgjedhësve. Nganjëherë, në dispozitat ligjore parashikohet që materialet informative dhe formularët duhet të jepen në gjuhë të tjera të rajoneve, ku flitet gjerësisht më shumë se një gjuhë.

Ndër materialet për informimin e zgjedhësve duhet të përfshihet informacioni për:

-  Kriteret që duhen përmbushur për të pasur të drejtën e votës;
-  Procedurat e regjistrimit;
-  Dokumentet e identifikimit, të domosdoshme për regjistrim;
-  Vendndodhjen dhe orarin e punës së punonjësve të regjistrimit; dhe
-  Afatin e paraqitjes së kërkesave për regjistrim ose ndryshime në listat e zgjedhësve.

Partitë politike mund të kontribuojnë në rritjen e përpjekjeve të autoriteteve publike sa i takon informimit të zgjedhësve, duke e shpërndarë këtë informacion përmes rrjeteve të tyre të mbështetësve. Gjithashtu, një shoqëri civile aktive mund të luajë rol të rëndësishëm në kryerjen e fushatave të informimit të zgjedhësve, ndonëse përpjekje të tilla duhet ta plotësojnë, dhe jo ta zëvendësojnë, rolin e administratës zgjedhore për informimin e zgjedhësve.

Çështje për diskutim: Transparenca dhe këqyrja nga publiku

- A është përgjithësisht transparent procesi i regjistrimit të zgjedhësve?

- A publikohen dhe/ose afishohen listat paraprake të zgjedhësve për një periudhë të parashikuar për këqyrje nga publiku?

- A është i mjaftueshëm afati kohor i parashikuar për këqyrje nga publiku që palët e interesuara në zgjedhje të kenë mundësi t'i shqyrtojnë listat dhe të kërkojnë ndryshime?

- A është i mjaftueshëm afati kohor i parashikuar për këqyrje nga publiku për përpunimin e çdo ndryshimi të kërkuar dhe çdo ankimimi?

- A u vihen në dispozicion regjistrat e zgjedhësve dhe/ose listat e zgjedhësve partive politike dhe grupeve të shoqërisë civile përpara afatit të fundit të mbylljes së listave?

- A u vihen në dispozicion listat përfundimtare të zgjedhësve partive politike dhe grupeve të shoqërisë civile?

- A kanë bërë përpjekje administratorët e zgjedhjeve dhe punonjësit e tjerë për t'i informuar zgjedhësit dhe palët e interesuara lidhur me periudhën e parashikuar për këqyrje nga publiku dhe veprimtari të tjera për regjistrimin e zgjedhësve?

- A ka pretendime për pasaktësi në listat e zgjedhësve që mund të ndikojnë në besimin e përgjithshëm në procesin zgjedhor? Në rast se po, a janë të mbështetura me prova këto akuza?

Vlerësimi i saktësisë

Vetëm një regjistër i saktë zgjedhësish mund të garantojë të drejtën universale dhe të barabartë për të votuar. Njëkohësisht, mbajtja e regjistrit të zgjedhësve i përditësuar siç duhet paraqet sfida të konsiderueshme për punonjësit e regjistrimit. Është e rëndësishme që vëzhguesit të kenë dijeni për këto çështje dhe të jenë të përgatitur për të bërë një vlerësim të saktësisë së regjistrit të zgjedhësve dhe performancës së administratorëve përkatës për garantimin e saj. Në kapitullin vijues analizohet çështja e rëndësishme e saktësisë dhe si mund ta trajtojnë atë vëzhguesit.

A. Rreth saktësisë

Ka disa aspekte të saktësisë që duhet të mbahen parasysh nga vëzhguesit e zgjedhjeve në vlerësimin e regjistrave të zgjedhësve:

- ☞ Çdo regjistrim duhet të lidhet me një zgjedhës me të drejtë vote;
- ☞ Informacioni duhet të jetë aktual, në mënyrë që të pasqyrojë ndryshimet e fundit në gjendjen civile ose të vendbanimit, si dhe ngjarjeve të ndryshme të jetës që prekin përbërës të gjendjes civile të zgjedhësit;
- ☞ Lista duhet të jetë e plotë, duke përfshirë të gjithë zgjedhësit me të drejtë vote; dhe
- ☞ Nuk duhet të ketë gabime drejtshkrimore ose gabime të tjera tek të dhënat.

Njëkohësisht, vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të mbajnë parasysh se asnjë regjistër i zgjedhësve nuk është i përsosur. Listat e zgjedhësve paraqesin një “fotografim” të një segmenti të caktuar të popullsisë në një moment të caktuar në kohë. Për shkak të ndryshimeve në gjendjen civile ose të vendbanimit, “fotografimi” ndryshon dhe pasqyrimi i këtyre ngjarjeve në regjistra kërkon kohë.

Nuk ka standarde ndërkombëtare që parashikojnë ndonjë mënyrë numerike të shprehuri të saktësisë apo ndonjë kufi të pranueshëm gabimi në listat e zgjedhësve. Në një shoqëri ku zgjedhjet karakterizohen nga një shkallë e lartë e besimit të publikut, mund të ketë shqetësime të vogla rreth pasaktësive në listat e zgjedhësve. Njëkohësisht, në një kontekst ku publiku nuk ka shumë besim, pak pasaktësi mund të përbëjnë shkak për përhapje spekulimesh rreth një manipulimit të mundshëm në ditën e zgjedhjeve. Në legjislacionin e disa Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së për zgjedhjet parashikohen kërkesa specifike lidhur me pjesëmarrjen në votime, në mënyrë që zgjedhjet përkatëse

të jenë të vlefshme. Në rast të mospërmbushjes së kërkesave lidhur me pjesëmarrjen, shpeshherë, legjislacioni kërkon përsëritjen e zgjedhjeve. Në përgjithësi, pjesëmarrja përcaktohet bazuar në numrin e zgjedhësve të regjistruar duke numëruar firmat e zgjedhësve në listat e zgjedhësve në fund të ditës së zgjedhjeve. Prandaj, saktësia e përpilimit të listave të zgjedhësve merr rëndësi edhe më të madhe Megjithëse vlerësimi i saktësisë së regjistrimit të zgjedhësve dhe listave të zgjedhësve është çështje thelbësore për MVZ-të, ai përbën edhe një nga detyrat më të vështira. Meqenëse nuk ka gjasa që vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve t'i vëzhgojnë fazat fillestare të regjistrimit të zgjedhësve apo të kenë kohën dhe burimet e nevojshme për të bërë vlerësime të plota të regjistrimit të zgjedhësve, ata do të mbështeten kryesisht tek informacioni i marrë nga punonjësit e zgjedhjeve, partitë politike, grupet e shoqërisë civile dhe burime të tjera.

Megjithëse disa lloje të dhënash statistikore mund të jenë të dobishme për vëzhguesit e zgjedhjeve kur vlerësojnë saktësinë e regjistrimit të zgjedhësve, një informacion i tillë duhet trajtuar me kujdes. Siç përmendet më lart, veçanërisht të dhënat e censurit bazohen në metodologji të ndryshme nga ato të regjistrimit të popullsisë. Shifrat e regjistrimit të zgjedhësve mund të krahasohen me ato të zgjedhjeve të mëparshme për të parë nëse ka pasur luhajtje të konsiderueshme.

B. Garantimi i regjistrave të saktë

Listat e sakta të zgjedhësve janë produkt i një procesi të gjatë dhe, nganjëherë, të ndërlikuar të grumbullimit, përditësimit dhe përpunimit të të dhënave personale. Lista të sakta zgjedhësish mund të arrihen vetëm kur punonjësit, përgjegjës për përpilimin e tyre, e kryejnë detyrën e tyre në mënyrë të ndërgjegjshme dhe në kohë, dhe kur shtetasit i paraqesin të dhënat e tyre personale brenda afatit ligjor. Regjistrimi i saktë kërkon bashkërendimin e përpjekjeve si të punonjësve, ashtu dhe të zgjedhësve, por gabime mund të ndodhin gjithmonë. Përditësimi i rregullt dhe i saktë i regjistrimeve të zgjedhësve është thelbësor për saktësinë e listave të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve, veçanërisht në sistemet pasive të regjistrimit të zgjedhësve. Sidoqoftë, përditësimi i regjistrimeve kërkon kujdes të posaçëm për mbrojtjen e regjistrave nga regjistrimet e shumëfishta. Cilësia e këtij procesi varet nga efikasiteti i punonjësve të regjistrimit në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre. Analisti zgjedhor duhet të zhvillojë takime me punonjësit e regjistrimit dhe t'i pyesë se si sigurohen që përditësimet e regjistrimit të zgjedhësve të jenë të sakta dhe se me çfarë sfidash specifike përballen.

Në rastet kur përgjegjës për mbajtjen e të dhënave për gjendjen civile dhe vendbanimin janë institucione të ndryshme vendore, komunikimi i mirë ndërmjet tyre është thelbësor, veçanërisht në zonat e mëdha urbane, të cilat karakterizohen zakonisht nga migrimi intensiv. Po kështu, institucionet vendore duhet të kenë edhe mjetet për shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit me institucionet shtetërore, në mënyrë që çdo përditësim i bërë në nivel vendor të pasqyrohet në nivel qendror. Kur përgjegjësia për mirëmbajtjen e regjistrave të zgjedhësve ndahet ndërmjet disa institucioneve, shkëmbimi rregullisht dhe në kohë i të dhënave dhe informacionit është veçanërisht i nevojshëm, siç është

niveli i duhur i kompetencës dhe uniformitetit të procedurave. Regjistrat janë të saktë vetëm nëse shtetasit i informojnë punonjësit e regjistrimit në kohë për çdo përditësim në gjendjen e tyre civile, të vendbanimit apo regjistrimeve të zgjedhësve. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të shohin kujdes çdo faktor që mund të frenojë pjesëmarrjen apo të dëmtojë rëndë saktësinë e regjistrit të zgjedhësve. Për shembull, një afat i ngjeshur për regjistrimin e zgjedhësve mund të mos lejojë kohë të mjaftueshme që zgjedhësit të regjistrohen ose t'i përditësojnë të dhënat e tyre. Në zonat rurale, shtetasve mund t'u duhet të bëjnë rrugë të gjatë për t'u regjistruar, gjë që mund të përbëjë një faktor frenues.

Procesi i transferimit të të dhënave nga regjistrimet në letër në një regjistër të unifikuar në format elektronik, mund të lërë shteg për pikëpyetje lidhur me integritetin e të dhënave. Për shembull, të dhënat mund të përfshijnë shtetas, të cilët duken më të moshuar sesa mund të jenë në të vërtetë (që shpjegohet me vdekjet e paregjistruara, veçanërisht në zonat e veçuara rurale), apo që kanë mbiemra të ndryshëm ose kanë shumë mbiemra (për shkak të ndryshimit në gjendjen civile, zakonit vendas etj.). Në rrethana të tilla, mund të jetë e nevojshme që të bëhet korrigjimi i të dhënave bazë të vjetruara ose të dyfishta.²¹ Një tjetër metodë për përditësimin e regjistrit të zgjedhësve përfshin dërgimin e planifikuar çdo zgjedhësi të njoftimeve për informacionin në regjistrimin e tij/saj si zgjedhës. Në kuadrin ligjor duhet të parashikohen udhëzime si duhet ta përpunojnë punonjësit postën që kthehet si e padërguar. Disa shtete dërgojnë njoftime të tilla thjesht si një mënyrë për t'i nxitur zgjedhësit ta konfirmojnë ose përditësojnë informacionin, ndërsa shtete të tjera nuk dërgojnë asnjë njoftim. Të gjitha metodat e përditësimit ose heqjes së të dhënave bazë nga regjistri i shtetasve duhet të zbatohen me kujdes shumë të madh për të mos i hequr asnjë zgjedhësi me të drejtë vote mundësinë për ta ushtruar këtë të drejtë.

Ka gjasa që vështirësitë e zakonshme lidhur me regjistrimin e saktë të zgjedhësve të rriten gjatë periudhave të tranzicionit themelor politik apo në situatat pas konflikteve. Mund të ketë kufizime ndaj kapaciteteve institucionale dhe financimit. Në disa raste, duhet të krijohet një sistem i ri regjistrimi. Kur iniciohet një sistem i ri për regjistrimin e gjendjes civile ose regjistrimin e zgjedhësve, ndër sfidat kryesore përfshihen:

- ✎ Krijimi me kujdes i sistemit, përfshirë dhe qarkullimin e informacionit dhe komunikimin si ndërmjet institucioneve, ashtu dhe brendapërbrenda tyre;
- ✎ Qendrueshmëria e sistemit;
- ✎ Grumbullimi fillestar i të dhënave personale; dhe
- ✎ Pastrimi dhe riorganizimi i të dhënave.

Që një sistem i ri regjistrimi të fillojë të funksionojë në mënyrë të efektshme mund të nevojitet një punë e gjatë, e bashkërenduar në të gjithë vendin.

²¹ Disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së përpiqen ta bëjnë këtë duke shkuar në adresat fizike që përmban lista paraprake e zgjedhësve. Zakonisht, kjo organizohet nga administrata vendore.

C. Probleme të zakonshme

Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të jenë në dijeni të disa probleme të zakonshme lidhur me listat e zgjedhësve, në mënyrë që të jenë të përgatitur të vlerësojnë çdo pretendim politik. Në rastet kur besohet se listat përmbajnë një numër mjaft të madh zgjedhësish, mund të ngrihen pikëpyetje sa i takon integritetit të votës dhe akuza për mashtrim, siç është votimi i shumëfishtë. Në rastet kur besohet se në lista mungojnë njerëz, mund të ketë akuza për heqje të së drejtës së zgjedhësve për të votuar.

Ka disa arsye pse në listat e zgjedhësve mund të ketë një numër të tepërt njerëzish, përfshirë dhe:

- ✎ **“Personat e vdekur”** – emrat e personave të vdekur nuk janë hequr nga listat;
- ✎ **Migrimi i brendshëm** – njerëzit kanë lëvizur brenda vendit, por as nuk janë çregjistruar vetë dhe as i ka çregjistruar njeri nga listat e zgjedhësve në vendbanimin e tyre të mëparshëm; dhe
- ✎ **Migrimi i jashtëm** – njerëzit kanë shkuar jashtë vendit, por nuk janë çregjistruar ose kanë të drejtën të mbeten në listën e zgjedhësve, në mënyrë që të ruajnë të drejtën për të votuar.

Nuk është e pazakontë që një numër i madh njerëzish, nga një komunitet, të lëvizë brenda vendit apo të largohet jashtë vendit përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, për shkak të rrethanave ekonomike apo rrethanave të tjera. Në raste të tilla, mund të ketë emra të tepërt në listat e zgjedhësve.

Ka edhe disa arsye pse njerëzit mund të mos jenë në listat e zgjedhësve, përfshirë:

- ✎ **Mungesën e dokumentacionit të duhur** – mund të jenë lëshuar dhe mund të nevojiten dokumente të përditësuara votim, por segmente të caktuara të popullsisë, siç janë të moshuarit, mund të mos i kenë kërkuar këto dokumente;
- ✎ **Zgjedhësit e rinj** – zgjedhësit që mbushin moshën e lejuar për të votuar, mund të mos kenë kërkuar të përfshihen ose mund të mos jenë shtuar në listat e zgjedhësve; dhe
- ✎ **Pengesat ndaj pjesëmarrjes** – grupe të caktuara pa përkrahje, siç janë gratë, pakicat kombëtare, të pastrehët ose personat e zhvendosur, mund të mos jenë të përfaqësuar mjaftueshëm në listat e zgjedhësve për shkak të normave sociale, pengesave administrative ose praktikave diskriminuese.

Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet ta trajtojnë me kujdes çdo pretendim lidhur me pasaktësi në listat e zgjedhësve, si dhe çdo deklaratë zyrtare për saktësinë e regjistrimit të zgjedhësve, përfshirë dhe të dhënat numerike. Është e zakonshme që, gjatë një periudhe zgjedhore, të tilla pretendime të kthehen në çështje politike. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të kërkojnë prova lidhur me çdo pretendim për pasaktësi ose manipulim të listave

të zgjedhësve. Gjithashtu, ata duhet të marrin informacion nëse është bërë ndonjë ankesë zyrtare, duke u kujtuar ndërkohë palëve të interesuara se MVZ-ja nuk është pjesë e procesit të gjyqimit ligjor.

D. Vështirësitë në marrjen e masave të posaçme për votim

Shumë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së lejojnë marrjen e masave të posaçme për votim, në mënyrë që të ndihmohen grupe të caktuara zgjedhësish, të cilët mund të gjenden larg vendit të tyre të banimit në ditën e zgjedhjeve. Disa shtete pjesëmarrëse marrin edhe masa për t'u dhënë mundësi zgjedhësve jashtë shtetit të votojnë ose që zgjedhësit të kenë mundësi të votojnë paraprakisht. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet ta dinë se të tilla masa të posaçme për votim mund ta ndërlikojnë detyrën e regjistrimit të zgjedhësve dhe mund të ndikojnë në saktësinë e listave të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve. Analisti i zgjedhjeve duhet të mësojë çfarë masash të posaçme lejon ligji për votim dhe si ndikon kjo në listat e zgjedhësve. Në disa vende, të dhënat bazë për të tillë "zgjedhës të veçantë" hiqen nga listat e zgjedhësve. Në vende të tjera, punonjësit e qendrave të votimit iu paraqitet një listë me vete e "zgjedhësve të veçantë", në mënyrë që t'u komunikohet se këta zgjedhës do të votojnë diku tjetër. Të tilla masa janë masa mbrojtëse ndaj votimit të dyfishtë dhe votimit të paautorizuar në vend të zgjedhësve që mungojnë. Vëzhguesit e zgjedhjeve mund të hasin këto lloje masash të posaçme për votim :

1. Zgjedhësit brenda vendit, larg vendbanimit të tyre

Gjatë regjistrimit të zgjedhësve, të cilët ndodhen larg vendit të tyre banimit gjatë periudhës së regjistrimit, duhet të bëhet dallimi midis zgjedhësve që vendosin të qëndrojnë larg vendit të tyre të banimit dhe atyre që ndodhen pashmangshmërisht larg vendit të tyre të banimit për shkak të detyrës apo izolimit. Në disa shtete pjesëmarrëse, ekziston mundësia që zgjedhësit, të cilët vendosin të qëndrojnë larg, ta regjistrojnë vendbanimin e përkohshëm dhe, më pas, të regjistrohen për të votuar në atë zonë zgjedhore ose të pajisen me një certifikatë votimi për zgjedhësit në mungesë. Në disa shtete të tjera pjesëmarrëse, e vetmja mundësi për këta zgjedhës është që të kthehen në vendin e tyre të banimit në ditën e zgjedhjeve dhe të votojnë atje. Në mënyrë alternative, disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së krijojnë mundësinë e votimit me postë.

Certifikata e votimit për zgjedhësit në mungesë: Certifikata e votimit për zgjedhësit në mungesë (CVM) lëshohet zakonisht nga autoritetet për t'u dhënë mundësinë zgjedhësve të votojnë në një tjetër qendër votimi, të ndryshme nga ajo në të cilin janë caktuar të votojnë. Praktika e mirë sugjeron që një zgjedhës i pajisur me një CVM të përfshihet në listën e zgjedhësve të qendrës "së re" të votimit, pas heqjes së emrit nga lista "e vjetër", dhe që CVM-ja t'i bashkëlidhet listës së zgjedhësve, pasi zgjedhësi të ketë hedhur votën e tij/të saj

Ndër zgjedhësit, të cilët ndodhen pashmangshmërisht larg vendit të tyre të banimit, zakonisht, përfshihen ushtarakët e karrierës dhe rekrutët, oficerët e policisë, studentët universitarë, të sëmurët në spitale, personat në institucionet e ndihmës ose kujdesit social, ekuipazhet e anijeve, të burgosurit dhe të ndaluarit. Përgjegjësinë për regjistrimin

e zgjedhësve nga këto kategori zgjedhësish, përgjithësisht, e kanë institucionet përkatëse dhe organet qendrore të administratës zgjedhore. Regjistrimi i personelit ushtarak ndryshon në Shtete të veçanta pjesëmarrëse të OSBE-së, veçanërisht për rekrutët. Në disa Shtete pjesëmarrëse, Ministria e Mbrojtjes mund t'u paraqesë autoriteteve të regjistrimit listat e rekrutëve dhe vendndodhjen e tyre, në mënyrë që të bëhet e mundur përfshirja e tyre në listat e zgjedhësve të civilëve në qendrat e votimit në rrethet ku kryejnë shërbimin. Në shtete të tjera pjesëmarrëse, për personelin ushtarak të bazave ushtarake ngrihen qendra të posaçme votimi, ndonëse përvoja më e mirë sugjeron që këto masa të merren vetëm si përjashtime. Ndërsa në disa shtete të tjera pjesëmarrëse, rekrutët votojnë me postë dhe votat e tyre dërgohen në zonat zgjedhore ku kanë vendbanimin e përhershëm. Së fundi, disa shtete pjesëmarrëse e ndalojnë votimin nga ana e personelit ushtarak, në kundërshtim me parimin e të drejtës universale dhe të barabartë për të votuar.

Masa të ngjashme për regjistrimin e zgjedhësve mund të merren për oficerët e policisë, ekuipazhet e anijeve, studentët universitarë, të sëmurët në spitale, personat në institucionet e ndihmës ose kujdesit social, të burgosurit dhe të ndaluarit. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të pyesin për këto masa dhe të vlerësojnë si është zbatuar parimi i të drejtës universale dhe të barabartë për të votuar sa u takon zgjedhësve brenda vendit që gjenden larg vendit të tyre të banimit. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të marrin informacion edhe lidhur me sistemin e rivendosjes së emrave të zgjedhësve në listat e zgjedhësve pas kthimit në vendbanimin e tyre.

2. Zgjedhësit jashtë vendit

Në disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së janë marrë masa për t'i lejuar shtetasit që gjenden përkohësisht jashtë vendit të votojnë por modalitetet ndryshojnë, meqenëse nuk ka standarde të qarta ndërkombëtare. Sa u takon masave për të votuar jashtë vendit, duhet të vendoset ekuilibri midis përfshirjes së zgjedhësve që i përmbushin kriteret për të votuar dhe garantimit të integritetit dhe transparencës së votës. Në shtete ku ka shqetësime lidhur me saktësinë e listave të zgjedhësve, nganjëherë, votimi jashtë vendit ka qenë faktor ndërlukues, pavarësisht nëse kjo është apo jo e argumentuar.

Megjithëse vëzhgimi i drejtpërdrejtë i votimit jashtë vendit është përgjithësisht jashtë fushëveprimit të një MVZ-je, është prapëseprapë e rëndësishme që vëzhguesit e zgjedhjeve të kuptojnë dispozitat dhe sistemin e regjistrimit të zgjedhësve jashtë vendit, duke qenë se ai ndikon drejtpërdrejt në saktësinë e listave të zgjedhësve. Në veçanti, është e rëndësishme të merret informacion nëse të dhënat bazë të zgjedhësve që ndodhen jashtë vendit mbeten në listat e zgjedhësve brenda vendit. Një numër Shtetesh pjesëmarrëse nuk parashikojnë votimin nga ana e zgjedhësve me të drejtë vote që jetojnë jashtë vendit. Në sistemet pasive të regjistrimit, të dhënat bazë të zgjedhësve që jetojnë jashtë vendit mbeten përgjithësisht në listat e zgjedhësve, pasi ata e ruajnë të drejtën e votës brenda vendit. Gjithsesi, kjo mund të lërë shkas për pretendime për abuzime nisur nga prezumimi se zgjedhësit brenda vendit që dinë hollësi personale të atyre që gjenden jashtë vendit, mund të votojnë më shumë se një herë.

Ndër shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që e lejojnë votimin jashtë vendit, ka disa ku zgjedhësit janë të detyruar të regjistrohen në përfaqësitë diplomatike paraprakisht dhe, më pas, t'i shuajnë regjistrimet dhe/ose të dhënat e tyre bazë në vendin e tyre, në mënyrë që të shmangët fryrja e mundshme e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar dhe mundësia për abuzim. Shtete të tjera pjesëmarrëse të OSBE-së e lejojnë regjistrimin sipas rastit të zgjedhësve, kur këta shkojnë për të votuar në qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike në ditën e zgjedhjeve. Në raste të tilla, zgjedhësit, që votojnë jashtë vendit dhe që mund të jenë të regjistruar rregullisht në listat e zgjedhësve në vendin e tyre, krijojnë një të dhënë bazë të re, ndoshta të dytë, që sjell si rezultat fryrjen e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar. Në raste të tilla, autoriteti përkatës duhet të verifikojë, pas zgjedhjeve, nëse ka pasur raste abuzimi, duke bërë krahasimin e listave të zgjedhësve brenda vendit me ato jashtë vendit.

3. Votimi paraprak

Një numër shtetesh pjesëmarrëse të OSBE-së ilejon zgjedhësit që ta hedhin votën e tyre në qendra të posaçme votimi përpara zgjedhjeve, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja dhe të ndihmojnë zgjedhësit që mund të mos kenë mundësi të votojnë në qendrat e tyre përkatëse të votimit në ditën e zgjedhjeve. Nganjëherë, votimi paraprak fillon disa javë përpara ditës së zgjedhjeve. Një vështirësi e veçantë që lidhet me votimin paraprak është përplasja që mund të ndodhë mes afateve të regjistrimit të zgjedhësve dhe atyre të votimit paraprak, duke qenë se votimi paraprak mund të ketë filluar që përpara se të përfundojë periudha e regjistrimit të zgjedhësve. Në shtete ku lejohet votimi paraprak, mund të jetë i nevojshëm një bashkërendim i posaçëm për të dalluar në listat e zgjedhësve në qendrat e votimit ata zgjedhës që aplikojnë votimin paraprak. Kjo siguron mbrojtje nga abuzimet e mundshme, siç është votimi shumë herë.

4. Votimi i lëvizshëm ose nga shtëpia

Një numër Shtetesh pjesëmarrëse të OSBE-së i lejon zgjedhësit, të cilët nuk mund të lëvizin, të votojnë nga shtëpia. Zgjedhësit që nuk lëvizin dot nga shtëpitë e tyre vizitohen nga një ekip i lëvizshëm votimi, përbërja e të cilit reflekton atë të komisionit të qendrës së votimit. Votimi mund të bëhet përpara ditës së zgjedhjeve ose gjatë ditës së zgjedhjeve. Zakonisht, rregullat parashikojnë që ekipet e lëvizshme të votimit t'i kthejnë fletët e votimit në qendrat e votimit para se të mbyllet votimi. Për këtë proces, listat e zgjedhësve të zgjedhësve që votojnë nga shtëpia hartohen bazuar në kërkesat e posaçme që bëjnë vetë këta zgjedhës. Këta zgjedhës duhet të hiqen nga listat e zakonshme të zgjedhësve në qendrat e votimit (listat mund edhe të pajisen me shënimet përkatëse). Komisioneve të qendrave të votimit do t'u duhet të bëjnë përpjekje të tjera procedurale si masë mbrojtëse nga abuzimi i mundshëm, siç janë shkeljet e fshehtësisë së votës (gjatë votimit, si dhe gjatë numërimit), ushtrimi i ndikimit tek zgjedhësit dhe orvatjet për të votuar shumë herë.

5. Votimi elektronik dhe përdorimi i teknologjive të reja të votimit

Shtetet pjesëmarrëse vazhdojnë të hulumtojnë mundësitë e teknologjive të reja të votimit (TRV) në zhvillimin e zgjedhjeve, veçanërisht për lehtësimin e administrimit të zgjedhjeve dhe pjesëmarrjes në to. Vitet e fundit është rritur ndërgjegjësimi sa u takon kufizimeve të mundshme dhe rreziqeve, si pasojë e përdorimit të këtyre teknologjive apo aplikimit tejet të shpejtë të këtyre teknologjive. Megjithëse TRV-të mund ta bëjnë procesin zgjedhor më të lehtë njëherazi si për zgjedhësit, ashtu edhe për administratën zgjedhore, ato mundet që edhe të paraqesin probleme të reja sa u takon perceptimeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë në procesin zgjedhor. Për të qenë të efektshme, është jetike që TRV-të të gëzojnë besimin e publikut, duke përbushur të njëjtat angazhime të OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare si mjete tradicionale votimi, siç është garantimi i fshehtësisë së votës, si dhe i përgjegjshmërisë dhe transparencës së procesit të votimit dhe numërimit.

Vështirësitë lindin kur një Shtet pjesëmarrës u ofron zgjedhësve alternativa të shumta votimi, përfshirë dhe votimin përmes internetit. Në këto situata, është posaçërisht e vështirë të garantohet që të mos ndodhë votimi i dyfishtë. Kjo mund të arrihet ose me anë të certifikatave të votimit që kërkojnë një fjalëkalim të fshehtë, ose duke kërkuar që të bëhet kërkesë për votim përmes internetit. Për të tilla alternativa mund të parashikohet një periudhë kohore specifike gjatë votimit paraprak, kur mund të votojnë përmes internetit zgjedhësit, që i përbushin kriteret për të votuar. Autoritetet duhet të sigurojnë mbrojtje nga votimi i mundshëm shumë herë, domethënë, zgjedhësit, që aplikojnë votimin përmes internetit, duhet të identifikohen në regjistrin e zgjedhësve. Nëse një zgjedhës, i cili është regjistruar për të votuar përmes internetit, mbërrin në një qendër votimi dhe ka dëshirë të votojë me fletë votimi, vota elektronike duhet të anulohet. Përveç kësaj, përdorimi i TRV-ve lë shkas për lindjen e dy problemeve të tjera. E para ka të bëjë me parimet e mbrojtjes së të dhënave, pra nëse mbrohen dhe si mbrohen të dhënat personale gjatë përpunimit automatik të regjistrave të zgjedhësve. Problemi i dytë është si mbrohen të njëjtat të dhëna, krahas fshehtësisë së votës, pas hedhjes së votës. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës së heqjes së të dhënave, kur nuk nevojiten më, dhe nëse në legjislacionin për zgjedhjet parashikohen procedura për heqjen e të dhënave.

E. Auditimet e regjistrimit të zgjedhësve

Ka mënyra të ndryshme për të vlerësuar saktësinë e regjistrimit të zgjedhësve. Megjithëse, përgjithësisht, nuk është e mundur që MVZ-të të bëjnë testime lidhur me regjistrin e zgjedhësve, vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të hulumtojnë nëse janë bërë testime nga autoritetet apo nga palët e tjera të interesuara në zgjedhje. Gjithashtu, analistët e zgjedhjeve mund të lejohen nga administrata ose autoriteti përkatës të bëjnë testime të thjeshta në një bazë të dhënash të kompjuterizuar, siç janë kërkimet për të dhëna bazë të dyfishta ose regjistrime të paplota.

1. Testimet me kompjuter

Një metodë për vlerësimin e saktësisë së regjistrimit të zgjedhësve është testimi me kompjuter, i cili bëhet shumë lehtë në një bazë të dhënash regjistrimi të centralizuar (ose të lidhur në rrjet). Është praktikë e mirë zgjedhore që administrata përkatëse të kryejë auditime të rregullta të bazës së të dhënave të regjistrimit të zgjedhësve, veçanërisht për të identifikuar gabime të mundshme apo regjistrime të shumëfishta. Në rast se regjistri i zgjedhësve iu vihet në dispozicion partive politike dhe grupeve të shoqërisë civile në format numerik, edhe ato mund të bëjnë testime të regjistrimit të zgjedhësve dhe t'i publikojnë rezultatet në mënyrë që të krijohet besimi i publikut në një regjistër të saktë, ose të sugjerohen përmirësime në një regjistër të pasaktë.

Në kuadrin ligjor duhet të parashikohet shpeshtësia me të cilën autoritetet e regjistrimit duhet të bëjnë auditimin e regjistrave apo listave të zgjedhësve, pavarësisht nëse sistemi për regjistrimin është aktiv apo pasiv. Ndër këto auditime mund të përfshihen edhe verifikimet sistematike me mënyra krahasuese me bazat publike të të dhënave që mbajnë agjenci të tjera dhe aplikimi i programeve kompjuterike të brendshme, të ndërtuara për të zbuluar të dhënat bazë të diskutueshme. Në vijim të auditimit, çdo përditësim i mundshëm i regjistrimit të zgjedhësve duhet të bëhet në pajtim me procedurat e njohura dhe nga autoriteti, që mban regjistrin e zgjedhësve.

2. Testimet në terren

Grupet e shoqërisë civile ose partitë politike mundet edhe të kryejnë një sërë verifikimesh rastësore të regjistrimit të zgjedhësve ose listave të zgjedhësve, në mënyrë që të përcaktojnë nëse të dhënat përkojnë me zgjedhësit dhe nëse të gjithë zgjedhësit, të cilët duhet të jenë në listat e zgjedhësve, janë regjistruar me saktësi.²² Një sondazh i tillë mund të jetë një veprimtari e gjerë dhe kërkon një rrjet të gjerë vullnetarësh të shtrirë në të gjithë vendin. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të kenë njohuri për metodologjinë bazë për kryerjen e këtyre testimeve, në mënyrë që të arrijnë të vlerësojnë besueshmërinë e rezultateve.

Ka dy lloje kryesore testimesh në terren që mund të bëhen për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve:

- 🔗 **Testimet nga listat tek njerëzit** vlerësojnë saktësinë e listave të zgjedhësve. Ideja e këtyre testimeve është që të identifikohen disa njerëz që nuk janë, por që duhet të jenë në lista, ose të identifikohen informacione që mund të jenë të vjetruara për shkak të ndryshimeve në gjendjen civile ose të vendbanimit. Vullnetarët përpiqen të lokalizojnë një kampion njerëzish, të cilët janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga lista e zgjedhësve për të përcaktuar nëse informacioni i tyre personal është i përditësuar dhe ende i saktë.

²² Për më shumë informacion, shih: "Krijimi i besimit të procesit të regjistrimit të zgjedhësve: udhëzues monitorimi i Institutit Demokratik Kombëtar për partitë politike dhe organizatat civile" (2001), i cili gjendet tek: www.ndi.org

- ✎ **Testimet nga njerëzit tek lista** vlerësojnë sa gjithëpërfshirëse janë listat e zgjedhësve. Ideja e këtyre testeve është që të identifikohen njerëz që duhet të jenë, por që nuk janë në lista. Vullnetarët përdorin metodën e përzgjedhjes rastësore të zgjedhësve me të drejtë vote në vende publike dhe, më pas, verifikojnë nëse këta zgjedhës janë apo jo në lista dhe nëse informacioni i tyre personal është i saktë.
- ✎ Që këto teste të jenë mjete të besueshme për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve, duhet të kryhen për kampione përfaqësuese të të dhënave bazë të listës së zgjedhësve dhe popullsisë.

Çështje për diskutim: Vlerësimi i saktësisë

- Përcaktoni cilat institucione janë të përfshira në përditësimin e regjistrimit të gjendjes civile dhe/ose regjistrin e zgjedhësve në praktikë dhe sipas dispozitave ligjore dhe vlerësoni si shkëmbehen dhe integrohen të dhënat nga burime të ndryshme.
- Kërkoni kopje të formularëve të regjistrimit ose formularëve që përdoren për të kërkuar përditësime në varësi të llojit të sistemit të regjistrimit të zgjedhësve. Vlerësoni nëse formularët janë në përputhje me kuadrin ligjor për regjistrimin.
- Kërkoni numrin e zgjedhësve të regjistruar, nëse është e mundur, për zonë zgjedhore.
- Krahasojni numrat e zgjedhësve të regjistruar me të dhëna të ngjashme nga zgjedhjet e fundit. Në rast luhatjesh të konsiderueshme, hulumtoni rrethanat e mundshme që mund t'i kenë shkaktuar ato.
- Bëni një vlerësim të efektivitetit të metodës së identifikimit, analizimit dhe pastrimit të gabimeve të mundshme në listat e zgjedhësve, si: grupet e regjistrimeve të mundshme të shumëfishta, të dhënat bazë të personave të vdekur, të dhënat bazë që mungojnë etj.
- Pyesni nëse është bërë ndonjë ankesë për procesin e regjistrimit të zgjedhësve ose për regjistrin e zgjedhësve dhe nëse ka pasur ndonjë reagim lidhur me to. Kërkoni opinio-net e partive politike dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile sa i takon saktësisë së listave të zgjedhësve.
- Nëse ka prova sa u takon pretendimeve për defekte serioze në regjistrin e zgjedhësve, pyetini punonjësit si mendojnë t'i trajtojnë dhe ndjekin ato.
- Identifikoni masat e posaçme të votimit dhe shqyrtoni se si mund të ndikojnë ato tek saktësia e listave të zgjedhësve.
- Merrni informacion nëse autoritetet e regjistrimit bëjnë auditime sistematike të regjistrimit të zgjedhësve dhe, nëse është kështu, merrni informacion për rezultatet e auditimit të mëparshëm. Pyesni çfarë masash marrin ato sa i takon rezultateve të auditimit.
- Pyetini vëzhguesit vendas nëse kanë bërë ndonjë testim me kompjuter ose në terren të listave të zgjedhësve për të përcaktuar saktësinë e tyre. Nëse kanë bërë, përpiquni të bëni një vlerësim të metodologjisë së tyre dhe t'i shqyrtoni gjetjet e tyre..
- Në rast pasaktësisë në listat e zgjedhësve, bëni një vlerësim nëse ato prekin ndonjë grup të caktuar apo grupe zgjedhësisë (domethënë, mbështetësit e një partie të caktuar, banorët e një zone të caktuar ose zgjedhësit që i përkasin një pakice kombëtare).

Vlerësimi i Përfshirjes dhe Mosdiskriminimit

Një aspekt i rëndësishëm i universalitetit dhe barazisë së të drejtës për të votuar është që listat e zgjedhësve të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përpilohen mbi baza mosdiskriminuuese. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përfshirjes së pakicave kombëtare, grave dhe të pastrehëve në regjistrin e zgjedhësve dhe në listat e zgjedhësve. Në situata pas konflikteve, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përfshirjes së PZHBV-ve dhe refugjatëve. Në kapitullin vijues analizohet si mund t'i shqyrtojnë MVZ-të këto çështje dhe të bëjnë vlerësimin e përfshirjes së procesit të regjistrimit të zgjedhësve.

A. Pjesëmarrja e pakicave kombëtare

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar që të mbrojnë të drejtat e pakicave kombëtare për të marrë pjesë në jetën publike, përfshirë dhe zgjedhjet. Edhe Këshilli i Evropës i ka trajtuar të drejtat politike të atyre, që u përkasin pakicave kombëtare, në Konventën e tij Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.²³ Megjithëse këto instrumente ndërkombëtare, si dhe dispozitat kushtetuese dhe legjislacioni për zgjedhjet, mbrojnë në mënyrë specifike të drejtat e pakicave kombëtare për pjesëmarrje, në praktikë ato mund të sjellin si rezultat diskriminim, veçanërisht sa i takon pjesëmarrjes në politikë.

Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të analizojnë se si e lehtësojnë apo e shkurajojnë dispozitat dhe procedurat për regjistrimin e zgjedhësve pjesëmarrjen në politikë të grupeve të pakicave. Megjithëse në një MVZ mund të përfshihet një ekspert për çështjet e pakicave kombëtare, të gjithë pjesëtarët e ekipit kryesor duhet t'i ndjekin këto çështje në kuadër të përgjegjësisë të tyre. Njëkohësisht, VAGJ-të dhe VASH-të duhet të marrin informacion edhe për çdo çështje që cenon pjesëmarrjen e pakicave, në mënyrë që të rritet aftësia e tyre për të vëzhguar. ODIHR-i ka botuar udhëzues të veçantë për pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në zgjedhje, që ofrojnë udhëzime të mëtejshme se si mund t'i trajtojnë MVZ-të këto çështje²⁴

²³ Këshilli i Evropës, Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Strasburg, 1 shkurt 1995, Sekcioni III, neni 20.

²⁴ OSBE/ODIHR, "Udhëzues për të ndihmuar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në procesin zgjedhor", gjen-det tek: <http://www.osce.org/odihr/elections/13963>.

Popullsitë e pakicave që përdorin gjuhë jozyrtare mund të mos lejohen të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë dhe/ose të zgjedhësve. Teorikisht, formularët e regjistrimit, informacioni dhe materialet informuese për regjistrimin e zgjedhësve duhet të vihen në dispozicion në gjuhët e pakicës, veçanërisht në zonat ku gjuhë të tilla përdoren gjerësisht. Gjithashtu, mund të shihet edhe mundësia e afishimit të listave të zgjedhësve në gjuhët e pakicave, përveçse në gjuhën zyrtare, në mënyrë që zgjedhësit ta kenë më të lehtë t'i gjejnë emrat e tyre.²⁵ Në rastet kur përdoren shumë gjuhë, gabimet në përkthim ose tejshkrim në listat e zgjedhësve mund të cenojë aftësinë e zgjedhësve, që i përkasin kësaj kategorie, për të gjetur emrat e tyre.

Një tjetër çështje e mundshme që mund të ketë ndikim shpërpjesëtimor në regjistrimin e zgjedhësve nga popullsitë e pakicave është sistemi për regjistrimin e zgjedhësve jashtë vendit. Popullsitë e pakicave, shpeshherë, jetojnë në zona në afërsi të kufijve shtetërorë dhe mund të kenë pjesëtarë të familjes në anën tjetër të kufirit. Në zona të tilla, ndodhin kalime të shpeshta të kufirit nga shtetasit e pakicave. Në rast se një shtet vendos t'i përjashtojë nga listat e zgjedhësve shtetasit që e kanë kaluar kufirin pas afatit të kalendarit të zgjedhjeve dhe nuk janë regjistruar pasi janë kthyer, atëherë të tilla përjashtime mund ta cenojnë në mënyrë shpërpjesëtimore popullsinë e pakicës.

Është thelbësore që vëzhguesit e zgjedhjeve të kuptojnë vështirësitë që mund ta pengojnë një grup specifik të pakicës të regjistrohet apo ta regjistrojnë për të votuar. Për shembull, romët (komunitetet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve), shpeshherë, jetojnë në vendbanime informale dhe, si të tillë, nuk kanë një adresë zyrtare dhe mund të mos regjistrohen si banues të ligjshëm. Në disa Shtete pjesëmarrëse, romët mund të dëmtohen nga mungesa e dokumenteve ose identifikimit personal dhe, si të tillë, mund të mbeten të përjashtuar nga regjistri i zgjedhësve.

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë zbatuar qasje të ndryshme për të bërë numërimin e popullsisë të pakicave kombëtare. Si rezultat, disa shtete mund të jenë në gjendje ta bëjnë numërimin e pakicave përkatëse, ndërsa shtete të tjera mund të mos jenë në gjendje. Gjithsesi, përgjithësisht, çmohet se përfshirja e informacionit personal për etninë në listat e zgjedhësve largohet nga praktika e mirë.²⁶ Njëkohësisht, në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, vendet iu caktohen kandidatëve të pakicës kombëtare, të cilët zgjidhen nga pjesëtarë të asaj pakice. Në raste të tilla, zgjedhësve mund t'u duhet të regjistrohen në një listë të posaçme të zgjedhësve ose mund t'u duhet të identifikohen si pjesëtarë të një komuniteti të pakicave në ditën e zgjedhjeve.

25 Në bazë të paragrafit 32.5 të Dokumentit të Kopenhagenit, pakicat kombëtare kanë të drejtën "për të përhapur, shkëmbyer dhe hyrë në informacionin në gjuhën e tyre amtare". Shih, gjithashtu, Konventën Kuadër (neni 9, paragrafi 1) dhe Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias (paragrafi I.3).

26 Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias, f. 12; shih, gjithashtu, Seksionin 2.4.c në f. 30. Shih, gjithashtu, Konventën Kuadër (neni 15), që parashikon se as kandidatëve, as zgjedhësve nuk duhet t'u kërkohet të tregojnë përkatësinë e tyre në pakicat kombëtare.

B. Pjesëmarrja e grave

Gëzimi i të drejtave të barabarta, përfshirë dhe të drejtën për pjesëmarrje në jetën politike, pavarësisht gjinisë, është pranuar në dokumentet për të drejtat e njeriut që nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e vitit 1948.²⁷ Dokumente të kohëve të fundit, siç është KEDNG-ja, i detyrojnë shtetet të garantojnë të drejtat e pjesëmarrjes së barabartë për gratë dhe burrat si zgjedhës dhe kandidatë. Megjithatë, gratë, shpeshherë, hasin pengesa ndaj përfaqësimit të drejtë dhe efektiv për shkak të diskriminimit mbi baza gjinore, shpeshherë të rrënjosura në praktikat dhe stereotipet tradicionale kulturore, përfshirë dhe sa i takon pjesëmarrjes së tyre në jetën publike.

Në këtë kontekst, vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të bëjnë një vlerësim të shkallës në të cilën dispozitat dhe procedurat për regjistrimin e zgjedhësve lehtësojnë ose shkurajojnë pjesëmarrjen e grave në politikë. ODIHR-i ka botuar një manual për të ndihmuar vëzhguesit në kryerjen e kësaj detyre.²⁸ Ndonëse në disa MVZ mund të përfshihet një analist për çështjet gjinore, është përgjegjësia e të gjithë pjesëtarëve të ekipit kryesor që t'i ndjekin këto çështje në kuadër të përgjegjësisë të tyre të përgjithshme. Çështje të caktuara, që pengojnë pjesëmarrjen e grave, duhet të sillen në vëmendje të të gjithë vëzhguesve, në mënyrë që të rriten aftësitë e tyre për të bërë vlerësimin e procesit.

Në kuadër të regjistrimit të zgjedhësve, shtetet duhet të përpiqen të krijojnë sisteme regjistrimi, që lehtësojnë barazinë e plotë të pjesëmarrjes për burrat dhe gratë. Duhet të trajtohen vazhdimisht praktikat, në disa shtete pjesëmarrëse, që ende përcaktojnë t'ia veshin kryefamiljarit autoritetin vendimmarrës në emër të të afërmeve gra. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të jenë veçanërisht të vëmendshëm se si mund të ndikojnë tek proceset e regjistrimit të zgjedhësve dhe votimit zakone të tilla themelore, përfshirë dhe mundësinë për të përdorur mjete të ligjshme juridike. Informacioni i përgjithshëm për shkallën e analfabetizimit tek burrat dhe gratë mund të jetë i vlefshëm, për të përcaktuar nëse fushatat ndërgjegjësuere për regjistrimin e zgjedhësve janë të përshtatshme, dhe nëse bëhen fushata të veçanta, që vënë në shënjestër zgjedhëset gra. Mund të jetë e dobishme të përcaktohet si i trajtojnë institucionet përgjegjëse për regjistrimin e zgjedhësve ndryshimet e emrave të grave pas martesë dhe nëse gratë, në mënyrë të posaçme, përballen me vështirësi në marrjen e dokumenteve të nevojshme, p.sh.: pas ndryshimit të vendbanimit. Megjithëse dispozitat kushtetuese dhe legjislativi për zgjedhjet shprehen në mënyrë të posaçme sa i takon barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave të grave, në praktikë, gratë ende mund të qëndrojnë në periferi të jetës publike, veçanërisht sa i takon pjesëmarrjes në politikë dhe votimit.

Në rastet kur në regjistrin e zgjedhësve shënohet gjinia, është e vlefshme që kjo e dhënë të krahasohet me të dhënat e censusit, në mënyrë që të përcaktohet nëse gratë regjistrohen për të votuar me të njëjtën shpeshësi që regjistrohen burrat. Përgjithësisht,

²⁷ Shih tek: <http://www.un.org/en/documents/udhr/index.shtml>.

²⁸ OSBE/ODIHR: "Manual për monitorimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje", gjendet tek: <http://www.osce.org/odihr/elections/13938>.

kjo është më e lehtë në rastin e sistemeve pasive për regjistrimin, meqenëse, zakonisht, këto sisteme parashikojnë përfshirjen e informacionit për gjininë në regjistrimet individuale. Megjithëse mund të jetë vështirë që në sistemet aktive për regjistrimin të gjendet informacion i ngjashëm, i ndarë sipas gjinisë, të dhëna të tilla janë me interes të posaçëm, meqenëse ky informacion tregon nëse gratë dhe burrat kanë ndërmarrë iniciativë të barabartë për pjesëmarrje. Faktorë të ndryshëm (p.sh.: mundësia për të shkuar në zyrat e regjistrimit dhe vendndodhja e tyre, mundësia për të udhëtuar).

C. Pjesëmarrja e personave të zhvendosur

Zhvendosja e një numri të konsiderueshëm personash nga vendbanimi i tyre mund të ndodhë gjatë dhe pas konflikteve të armatosura, trazirave sociale ose fatkeqësive natyrore. Në rrethana të tilla, shteti i cenuar duhet të tregojë kujdes të posaçëm për të garantuar regjistrimin e personave të zhvendosur, përfshirë dhe zgjedhësit, dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje. Organizatat ndërkombëtare, si: Kombet e Bashkuara, OSBE-ja ose Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM), mund të luajnë një rol aktiv në regjistrimin e personave të zhvendosur si zgjedhës.

Personat e zhvendosur brenda kufijve të shtetit të tyre të shtetësisë, përgjithësisht, *njihen si persona të zhvendosur brenda vendit* (PZHBV-të), ndërsa personat e zhvendosur jashtë kufijve të shtetit të tyre të shtetësisë, përgjithësisht, njihen si *refugjatë*. Pjesëmarrja në zgjedhje e personave të zhvendosur duhet të jetë në pajtim me legjislacionin e shtetit të shtetësisë të personave në fjalë. Megjithëse autoritetet duhet të marrin masat e nevojshme, në mënyrë që të garantojnë që PZHBV-të të kenë mundësi të votojnë, votimi nga ana e refugjatëve varet nga fakti nëse shteti e siguron votimin jashtë vendit apo ka marrë masa të posaçme për të bërë të mundur që refugjatët të votojnë.

Disa çështje mund të jenë pengesë për përfshirjen e personave të zhvendosur në listat e zgjedhësve:

- ✎ Shpeshherë, popullsitë e zhvendosura janë të përkohshme, pavarësisht nëse lëvizin në mënyrë të pavarur nga njëra vendndodhje në tjetrën, gjejnë strehim në kampe ose strehime të përkohshme dhe/ose, më pas, largohen nga autoritetet përkatëse për në ndonjë vendndodhje tjetër;
- ✎ Personat e zhvendosur mund t'i kenë humbur dokumentet e tyre të identitetit dhe mund të kenë qasje të kufizuar në agjencitë, të cilat mund të bëjnë zëvendësimin e këtyre dokumenteve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në zona, në të cilat regjistrimet e gjendjes civile janë grabitur ose asgjësuar; dhe personat e zhvendosur mund të ngurrojnë të regjistrohen nga frika e kanosjes apo ndëshkimit.

Në disa raste, personat e zhvendosur, të sistemuar në një komunitet të caktuar, mund t'i përmbushin kriteret për t'u regjistruar, në mënyrë që të votojnë në njësinë administrative, ku kanë banuar përpara zhvendosjes. Megjithatë, ata mund të ngurrojnë

të regjistruohen atje për shkak të çështjeve të sigurisë personale apo nga frika se regjistrimi në komunitetin e tyre të mëparshëm mund të sjellë si rezultat humbjen e të drejtave, që lidhen me statusin e tyre si person i zhvendosur. Gjithashtu, disa sisteme zgjedhore mazhoritare mund të shkaktojnë kufizimin e të drejtës së votës për PZHBV-të, meqenëse pjesëmarrja lidhet me regjistrimin në një zonë të caktuar zgjedhore.

Në vende me popullsi të zhvendosura, vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të zhvillojnë takime me autoritetet përkatëse dhe të marrin dijeni se çfarë masash janë marrë për regjistrimin e këtyre personave si zgjedhës. Nëse për PZHBV-të ka strehime të përkohshme, MVZ-ja duhet të bëjë përpjekje për t'i vizituar ato dhe për të vëzhguar praktikën e regjistrimit të zgjedhësve.

D. Pjesëmarrja e të pastrehëve

Të pastrehët, gjithashtu, kërkojnë vëmendje të veçantë, meqenëse ata mund të mos jenë të regjistruar në regjistrin e zgjedhësve, për shkak të mungesës së një vendbanimi të regjistruar. Praktika e mirë tregon se vendbanimi ose adresa nuk duhet të përkufizohet, në mënyrë të tillë që të përjashtojnë nga votimi njerëz pa një vendbanim apo adresë të regjistruar, të cilët, në fakt, i përmbushin kriteret për të votuar. Vëzhguesit duhet të analizojnë nëse janë marrë masa paraprake dhe të çfarë lloji për të garantuar që të pastrehët të votojnë.

Çështje për diskutim: Gjithëpërfshirja e regjistrimit të zgjedhësve

- Identifikoni çdo grup, që mund të jetë përjashtuar, qoftë dhe pjesërisht, nga regjistrimi i zgjedhësve për shkak të mangësive burokratike ose të përgjithshme të procesit. Bëni një vlerësim nëse kultura tradicionale vendase mund të ketë ndikuar në gjithëpërfshirjen e regjistrimit të zgjedhësve, në rajone të veçanta apo në të gjithë vendin.

- Pyesni çfarë dokumentesh kërkohen për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve për t'u regjistruar. Përcaktoni nëse mund të ekzistojnë rrethana, si pasojë e të cilave një person nuk i ka këto dokumente ose aftësia e një personi për t'i marrë ato kufizohet.

- Përcaktoni nëse ekzistojnë kërkesa ose kosto sa i takon zotësisë për të shkruar dhe lexuar, që mund t'i pengojnë zgjedhës të caktuar për të marrë pjesë.

- Në rastin e popullsisë të pakicave kombëtare, pyesni nëse informacioni dhe formularët e regjistrimit disponohen në gjuhën(gjuhët) e tyre.

- Pyesni autoritetet çfarë statistikash disponohen për numrin e grave të regjistruara për të votuar, krahasuar me burrat.

- Nëse perceptohet se gratë ose popullsitë e pakicave kombëtare nuk janë të përfaqësuara mjaftueshëm në listat e zgjedhësve, përcaktoni nëse autoritetet vendore apo shoqëria civile zhvillojnë programe të veçanta për të inkurajuar dhe lehtësuar regjistrimin e tyre.

-
- Pyesni për kohën e banimit, e nevojshme për përmbushjen e kriterëve për të votuar në zgjedhje, dhe afatin e fundit për regjistrim dhe analizoni nëse këta faktorë mund të ndikojnë negativisht tek ndonjë grup zgjedhësish, veçanërisht tek zgjedhësit, të cilët mund të kenë ardhur kohët e fundit ose kultura tradicionale e të cilëve kërkon një mënyrë më të paqëndrueshme jetese.

 - Përcaktoni nëse ka kampe të posaçme apo strehime të tjera të përkohshme, të ngritura për personat e zhvendosur, apo nëse ka rajone të veçanta ku mund të ketë përqendrim më të mëdha të popullsisë të zhvendosura.

 - Bëni përpjekje për të marrë informacion lidhur me numrin real të personave të zhvendosur, përfshirë dhe PZHBV-të e refugjatët. Përcaktoni statusin e tyre të banimit dhe shtetësisë.

 - Pyesni për ndonjë masë, që mund të jetë marrë, për t'i pajisur personat e zhvendosur me dokumente zyrtare të identitetit apo dokumente të tjera, që pasqyrojnë statusin e tyre. Përcaktoni nëse janë bërë përpjekje (dhe nga cili) për t'i ndihmuar ata, në mënyrë që të regjistrohen për të votuar.

 - Përcaktoni nëse dispozitat ligjore ose rregulloret e lejojnë që PZHBV-të të votojnë në vendndodhjen e tyre aktuale ose në vendbanimin e mëparshëm, si dhe nëse PZHBV-të mund ta ushtrojnë kështu të drejtën e tyre të votës.

 - Bëni pyetje lidhur me dispozitat, ku parashikohet mundësia që të pastrehët të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar.
-

Listat e zgjedhësve dhe dita e zgjedhjeve

Cilësia e listave të zgjedhësve vihet në provë në qendrat e votimit, në ditën e zgjedhjeve. Identifikimi dhe përpunimi i zgjedhësve në qendrat e votimit mund të japin sinjale të qarta sa i takon integritetit të procesit të regjistrimit të zgjedhësve, në tërësi. Në kapitullin vijues shpjegohen çështjet, që lidhen me përdorimin e listave të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve, ndërsa jepen udhëzime si mund ta vëzhgojnë në mënyrë sa më të efektshme këtë proces MVZ-të.

A. Struktura e listave të zgjedhësve


Në bazë të përvojës më të mirë, legjislacioni duhet të shprehet qartë sa i takon të dhënave personale, të nevojshme për të dhënat bazë individuale të listave të zgjedhësve, që përdoren në qendrat e votimit në ditën e zgjedhjeve. Kjo garanton transparencën dhe uniformitetin e listave të zgjedhësve për një lloj të caktuar zgjedhjesh. Përgjithësisht, çmohet se një person mund të identifikohet nga emri i tij/saj, mbiemri dhe data e lindjes. Metoda të tjera, që përdoren për të identifikuar zgjedhësit, bazohen tek adresa, numri i një dokumenti identifikimi, siç është pasaporta, numri individual i regjistrimit të zgjedhësit ose numri unik personal i identifikimit. Kur botojnë regjistrin e zgjedhësve apo listat e zgjedhësve, autoritetet duhet të marrin në konsideratë shqetësimet lidhur me privatësinë dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave, siç përshkruhet në Kapitullin IV.D. Nëse regjistrat e popullsisë dhe/ose të zgjedhësve janë organizuar si baza të dhënash, pjesa më e madhe e programeve kompjuterike të bazave të të dhënave e lejon që të dhënat të renditen sipas një numri fushash. Kështu, një regjistër i vetëm mund të lejojë paraqitjen e të dhënave në lista të formateve të ndryshme. Në shumicën e rasteve, listat e zgjedhësve të qendrave të votimit organizohen me të dhënat bazë të renditura, në rend alfabetik, në bazë të mbiemrave ose adresave, nëse adresat janë vënë në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha zonat urbane dhe rurale. Në përgjithësi, zgjedhja e mënyrës së renditjes së të dhënave bëhet duke mbajtur parasysh informacionin, që përmbajnë dokumentet personale të identitetit, që përdoren më së shumti për identifikimin e zgjedhësve, në mënyrë që të garantohet përpunimi me efektivitet dhe me qetësi i zgjedhësve nga punonjësit e qendrave të votimit. Duket se renditja e të dhënave bazë të listës së zgjedhësve në bazë të mbiemrit, në rend alfabetik, është praktika më e përhapur në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Kjo praktikë lejon identifikimin e zgjedhësve, në ditën e zgjedhjeve, në bazë të dokumenteve personale të identitetit, në të cilat nuk shënohet adresa. Gjithashtu, këto lista të zgjedhësve janë të vlefshme në zona, ku adresat nuk janë caktuar në mënyrë të njëtrajtshme, si dhe në shtetet pjesëmarrëse, ku në bazë të legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave adresat konsiderohen si të

dhëna të mbrojtura. Gjithashtu, është e mundur që, për periudhën e parashikuar për këqyrje nga publiku, listat paraprake të zgjedhësve të përpilohen me të dhëna bazë të renditura në bazë të adresave dhe, për ditën e zgjedhjeve, renditja në listat e zgjedhësve të bëhet në bazë të mbiemrit, në rend alfabetik. Në disa shtete pjesëmarrëse, listat e zgjedhësve afshohen në qendrën e votimit ose përreth saj, përpara votimit, në mënyrë që zgjedhësit të kenë mundësi të verifikojnë që emrat e tyre janë në listë dhe që ata ndodhen në qendrën e duhur të votimit.

B. Votimi

Të gjitha përpjekjet, që janë bërë për të përpiluar, përditësuar, këqyruar, botuar dhe shpërndarë listat e zgjedhësve, përmbliohen në ditën e zgjedhjeve. Lista e zgjedhësve është një nga dokumentet më të rëndësishme, të pranishme gjatë zhvillimit të votimit. Kjo listë, që përdoret gjatë gjithë ditës, përfshirë ndoshta dhe një listë shtesë të zgjedhësve, shërben si bazë për të përcaktuar numrin e njerëzve, që kanë votuar, duke e krahasuar këtë numër me numrin e fletëve të votimit, që janë shpërndarë, numrin e fletëve të votimit, që gjenden në kutitë e votimit, si dhe numrin e votave, që janë hedhur. Çështja më e rëndësishme për zgjedhësit është që, kur shkojnë për të votuar, t'i gjejnë emrat në listat e zgjedhësve dhe ka gjasa që kjo të ndikojë tek besimi i tyre në procesin e zgjedhjeve, në tërësi. Që të ndodhë kjo, zgjedhësit duhet të shkojnë në qendrën e duhur të votimit; prandaj, listat e zgjedhësve në qendrën e votimit duhet të pasqyrojnë me saktësi të dhënat personale të të gjithë zgjedhësve, që janë caktuar në qendrën përkatëse të votimit, dhe zgjedhësit duhet të jenë të informuar se në cilën qendër votimi janë caktuar. Ndonëse procedurat janë të ndryshme në shtete të veçanta pjesëmarrëse, në shumicën më të madhe të rasteve, hapi kryesor, që përfshin listën e zgjedhësve gjatë përpunimit të zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve, është identifikimi i zgjedhësve. Në përgjithësi, identifikimi i zgjedhësve caktohet me ligj, përfshirë edhe dhe çfarë dokumentesh dokumentesh kërkohen që një zgjedhës të lejohet të votojë. Në shumicën e rasteve, zgjedhësi i paraqet një dokument identiteti një punonjësi të qendrës së votimit, i cili ka detyrë që ta gjejë emrin e zgjedhësit në listën e zgjedhësve. Në disa shtete, një person pa një dokument identiteti mund të konsiderohet si i identifikuar, në rast se një a dy dëshmitarë e vërtetojnë identitetin e personit. Pasi gjendet emri i zgjedhësit, zgjedhësit i kërkohet që të firmosë në listën e zgjedhësve ose punonjësi i qendrës së votimit kundërnënshkruan ose vendos një shenjë përbri të dhënave bazë të zgjedhësit, në mënyrë që evidentohet se personi e ka marrë fletën e votimit. Punonjësit e trajnuar të qendrave të votimit, listat e sakta të zgjedhësve dhe zgjedhësit e informuar për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, në ditën e zgjedhjeve, kontribuojnë në të pasurit e një mjedisi të besimit të publikut dhe një procesi të qetë votimi. Në këto kushte, problemet në qendrat e votimit, përgjithësisht, janë të izoluar. Gjithsesi, gabimet në ndonjërin prej këtyre zonave mund të sjellin si rezultat vonesa, zhgënjim, ndërprerje të procesit të votimit apo madje trazira në qendrat e votimit.

Ka një sërë arsyes pse të dhënat bazë të zgjedhësit mund të mos gjenden në listën e zgjedhësve:

-  Zgjedhësi ka kërkuar korrigjimin apo transferimin e regjistrimit të tij/saj. Kur ka kërkuar transferimin, ai ose ajo mund të jetë regjistruar në një qendër tjetër votimi;

- ✎ Emri i zgjedhësit në listën e zgjedhësve ndryshon nga emri i tij/saj në dokumentin e identifikimit paraqitur prej tij/saj;
- ✎ Emri i zgjedhësit është lënë gabimisht jashtë;
- ✎ Zgjedhësi është caktuar në një qendër tjetër votimi; dhe
- ✎ Në një sistem aktiv regjistrimi, zgjedhësi nuk është regjistruar asnjëherë ose është regjistruar pas përfundimit të afatit për një lloj të caktuar zgjedhjesh.

Në varësi të kuadrit ligjor, kur të dhënat bazë të një zgjedhësi nuk gjenden në listën e zgjedhësve në qendrën e votimit, zgjedhësit i refuzohet fleta e votimit ose, nëse mund të përcaktohet përmbushja e kriterëve nga ana e tij/saj për të votuar, emri i zgjedhësit përfshihet në listën shtesë të zgjedhësve dhe zgjedhësit i jepet një fletë votimi. Në disa shtete pjesëmarrëse, në përcaktimin, në ditën e zgjedhjeve, të përmbushjes së kriterëve nga ana e zgjedhësit për të votuar, mund të përfshihen autoritetet e qeverisjes vendore, policia ose gjykatat. Në rrethana të tilla, zakonisht, legjislacioni për zgjedhjet i detyron këto institucione që të qëndrojnë hapur gjatë orëve të votimit. Në disa shtete pjesëmarrëse, zgjedhësi mund të lejohet që të votojë me një fletë votimi të *përkohshme*.

Fleta e përkohshme e votimit

Në disa shtete, për zgjedhësit, të cilët nuk janë në listën e zgjedhësve, jepet një fletë votimi e përkohshme në mënyrë që autoritetet vendore të regjistrimit ose një komision i lartë i zgjedhjeve, pas përfundimit të votimit, të kenë mundësi të verifikojnë nëse zgjedhësi e ka pasur apo jo të drejtën e votimit. Votat e zgjedhësve që e kanë pasur, në fakt, të drejtën e votës, numërohen. Praktika e mirë, në të tilla raste, sugjeron që zgjedhësve t'u jepet një fletë votimi, një zarf për të futur fletën e votimit që ajo të jetë e fshehtë dhe një zarf i jashtëm, ku zgjedhësi mund të japë gjeneralitetet e tij për verifikim të mëvonshëm

Në disa shtete pjesëmarrëse, punonjësit e qendrave zgjedhore pajisen me një pajisje kompjuterike, e cila u jep akses në listat e zgjedhësve për të gjithë zonën zgjedhore. Në një rast të tillë, punonjësit e qendrave të votimit kanë mundësi t'i informojnë zgjedhësit nëse janë në listat e zgjedhësve dhe, nëse po, në cilën qendër votimi.

C. Numërimi

Lista e zgjedhësve, përfshirë dhe një listë të mundshme shtesë të zgjedhësve, apo një listë të zgjedhësve, që aplikojnë votimin e lëvizshëm/nga shtëpia, bëhet pjesë përbërëse e numërimit të votave, pas mbylljes së votimit. Pavarësisht nëse votat numërohen në qendrën e votimit apo në ndonjë njësi tjetër, siç është qendra e numërimit e zonës zgjedhore, përgjithësisht, kërkohet që punonjësit e qendrave të votimit të plotësojnë një procesverbal, në të cilin të dokumentojnë veprimtarinë e votimit për qendrën e tyre të votimit. Në shumicën e rasteve, faza e parë e numërimit konsiston në përcaktimin e numrit të zgjedhësve, që kanë hedhur votën, duke llogaritur numrin e firmave në listën e zgjedhësve ose numrin e të dhënave bazë, që shënohen se kanë votuar nga punonjësit e qendrave të votimit, si dhe emrat e zgjedhësve në listën shtesë të zgjedhësve apo zgjedhësit, që kanë votuar me fletë votimi të përkohshme. Ky numër duhet të përkojë

me të dhënat bazë të procesverbalit për numrin e fletëve të votimit, që janë shpërndarë, dhe me numrin e fletëve të votimit në kutinë e votimit, pavarësisht ndonjë flete votimi, që mund të jetë prishur dhe zëvendësuar.

D. Vëzhgimi në ditën e zgjedhjeve

Vëzhguesit afatshkurtër mbërrin në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, ku zhvillohen zgjedhje, disa ditë përpara ditës së zgjedhjeve dhe largohen disa ditë pas ditës së zgjedhjeve, në përputhje me metodologjinë e ODHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Ekipi kryesor mund t'i udhëzojë VASH-të që të grumbullojnë informacion të dobishëm për përdorimin dhe cilësinë e listave të zgjedhësve në qendrat e votimit, në ditën e zgjedhjeve. Në parametrat standarde, që kanë parasysh vëzhguesit për qëllim të vëzhgimit të votimit, përgjithësisht, përfshihen disa pyetje lidhur me listat e zgjedhësve, pyetje që mund t'i përshtaten sistemit, që zbatohet në shtetin pjesëmarrës. Meqenëse numri i VASH-ve është i konsiderueshëm, gjetjet e tyre mund të sistemohen, në mënyrë që të përcaktohen tendencat kryesore sa i takon zbatimin të sistemit për regjistrimin e zgjedhësve. Një përmbledhje e konsoliduar e gjetjeve të VASH-ve duhet të ofrojë disa tregues të saktësisë së përgjithshme të listave të zgjedhësve dhe me sa efektivitet është organizuar faza e procesit të votimit, që përfshin listat e zgjedhësve, gjatë ditës së zgjedhjeve. VASH-të duhet të vëzhgojnë regjistrimin e zgjedhësve, në ditën e votimit, kudo që është e mundur.²⁹ VASH-të, gjithashtu, mund të vëzhgojnë nëse procesi i identifikimit të zgjedhësve ka vazhduar i qetë dhe në pajtim me rregulloret, pavarësisht nëse ka pasur zgjedhës në listën shtesë të zgjedhësve, pavarësisht nëse ka pasur zgjedhës, të cilëve nuk u janë dhënë fletë votimi, pasi emrat e tyre nuk kanë qenë në listë, dhe pavarësisht nëse ka pasur pretendime për votim të shumëfishtë. Njëkohësisht, është e rëndësishme që ekipi kryesor të mbajë parasysh se, ndërsa VASH-të mund të japin informacion për problemet, ata nuk janë në gjendje të përcaktojnë arsyen e problemeve me listat e zgjedhësve apo kush mund të jetë përgjegjës. Një analizë e hollësishme e çështjeve të tilla kërkon kohë dhe bashkëpunimin e plotë të autoriteteve përkatëse. Ankesat apo pretendimet lidhur me listat e zgjedhësve, në ditën e zgjedhjeve, mund të ndiqen nga VAGJ-të dhe ekipi kryesor, në mënyrë që të bëhet një vlerësim përfundimtar.

Çështje për diskutim: Listat e zgjedhësve dhe dita e zgjedhjeve

- Çfarë të dhënash personale përmbajnë listat e zgjedhësve dhe si janë organizuar ato? A mundësojnë një përpunim pa probleme të zgjedhësve?

- A u afshuan listat e zgjedhësve në qendrën e votimit apo përreth saj?

- Çfarë procedurash u përdorën për të identifikuar zgjedhësin dhe a mund të identifikohet nga dëshmitarë një zgjedhës pa dokument identiteti?

²⁹ Regjistrimi i zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve parashikohet në legjislacionin vendas të disa shteteve pjesëmarrëse. Parashikimi i kësaj procedure mbetet çështje partiake, duke i mëshuar më shumë dhënies së mundësisë për ushtrimin e votës sesa integritetit të saj. Në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias, pjesa 1.2.iv, thuhet se: "Duhet të ketë një procedurë administrative – objekt i kontrollit gjyqësor – apo një procedurë gjyqësore, që të lejojë regjistrimin e një zgjedhësi që nuk ka qenë i regjistruar; regjistrimi nuk duhet të bëhet në qendrën e votimit, në ditën e zgjedhjeve."

-
- Çfarë parashikon kuadri ligjor nëse emri i një zgjedhësi nuk gjendet në listën e zgjedhësve?

 - A refuzohet t'i jepet zgjedhësit fleta e votimit apo ekziston ndonjë mënyrë për të vendosur nëse zgjedhësi ka apo jo të drejtë vote ditën e zgjedhjeve? A ekziston edhe ndonjë opsion fletësh votimi të përkohshme si alternativë?

 - A e parashikon kuadri ligjor numërimin e zgjedhësve që shënohen se kanë votuar në listën e zgjedhësve për t'u krahasuar me numrin e fletëve të votimit të lëshuar dhe me numrin e fletëve të votimit në rutinë e votimit?

 - A kanë gjetur VASH-të prova të një numri të madh zgjedhësish, të cilëve iu janë refuzuar fletët e votimit, pasi nuk kanë qenë në listat e zgjedhësve, apo të rasteve të votimit të shumëfishtë? Si janë trajtuar këto raste?

 - A ka pasur grupe të dhënash bazë të shumëfishta brenda të njëjtës qendër votimi?

 - A janë përdorur lista shtesë të zgjedhësve dhe sa të dhëna bazë janë përfshirë në listat shtesë të zgjedhësve në kohën e vëzhgimit?

 - A ka pasur në ditën e zgjedhjeve ankesa ose pretendime nga palët e interesuara në zgjedhje lidhur me listat e zgjedhësve dhe si janë zgjidhur ato? A mbetën ankimesit të kënaqur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes?

 - A është përcaktuar si duhet pjesëmarrja e zgjedhësve gjatë numërimit në bazë të të dhënave bazë të zgjedhësve që në listën e zgjedhësve janë shënuar se kanë votuar?

E. Dita pas zgjedhjeve

Pas ditës së zgjedhjeve dhe pas shpalljes së rezultateve paraprake dhe përfundimtare, vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të bëjnë vlerësimin e rezultateve, duke u bazuar te numri i zgjedhësve të regjistruar, pjesëmarrja dhe te çështjet që mund të kenë lindur ditën e zgjedhjeve lidhur me regjistrimin e zgjedhësve, siç janë zgjedhësit që nuk janë lejuar të votojnë apo që nuk i kanë gjetur emrat e tyre në listë. Vëzhguesit e zgjedhjeve duhet të ndjekin, gjithashtu, edhe trajtimin e ankesave. Përveç kësaj, ekipi kryesor mund të jetë në gjendje t'i krahasojë të dhënat e marra nga VASH-të me rezultatet zyrtare, të dhënat për zgjedhësit e regjistruar, rritjen në regjistrimin e zgjedhësve (veçanërisht ditën e zgjedhjeve), zgjedhësit që kanë votuar atë ditë dhe shpalljen përfundimtare të shifrave të pjesëmarrjes. Një çështje që mund të lindë gjatë një procesi zgjedhor është që partitë mund të kërkojnë akses në listën e firmosur të zgjedhësve (domethënë listat e zgjedhësve që janë përdorur ditën e zgjedhjeve, të cilat përmbajnë firmat e personave që kanë votuar). Në legjislacionin vendas të disa shteteve pjesëmarrëse parashikohet publikimi i këtyre listave.³⁰ Çështje që duhet të merren në konsideratë kur vlerësohet publikimi janë fshehtësia e votës, mbrojtja e të dhënave, aksesit për vëzhguesit dhe besimi i përgjithshëm në procesin zgjedhor dhe në rezultatet e zgjedhjeve. Njëkohësisht, në sistemin e ankesave dhe ankimeve duhen parashikuar mjete juridike të ligjshme dhe efektive kurdoherë që palët e interesuara në zgjedhje shprehin dyshime për manipulim të pjesëmarrjes së zgjedhësve.

30 Në Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore e Komisionit të Venecias, pjesa I.4.c, thuhet se: "lista e personave, që votojnë faktikisht, nuk duhet të publikohet."

Ky manual ka për qëllim të japë disa udhëzime se si duhet trajtuar regjistrimi i zgjedhësve në kuadër të vëzhgimit të përgjithshëm të zgjedhjeve. Manuali bën një ndërthurje të shpjegimeve lidhur me aspektet teknike të regjistrimit të zgjedhësve dhe këshillave praktike se si duhet ta kryejnë këtë proces vëzhguesit e zgjedhësve.

Manuali përfshin këto pjesë:

- ▢ *Hyrjen*, ku përfshihen edhe standardet përkatëse ndërkombëtare dhe qasja e OSBE/ODIHR-it ndaj regjistrimit të zgjedhësve;
- ▢ *Terminologjinë e përdorshme* për të kuptuar regjistrimin e zgjedhësve;
- ▢ Një shpjegim të *karakteristikave të përgjithshme* të sistemeve të regjistrimit të zgjedhësve;
- ▢ Udhëzime për rishikimin e *kuadrit ligjor* për regjistrimin e zgjedhësve;
- ▢ Udhëzime për vlerësimin e *transparencës* lidhur me regjistrimin e zgjedhësve;
- ▢ Udhëzime për vlerësimin e *saktësisë* së regjistrimit të zgjedhësve;
- ▢ Udhëzime për vlerësimin e *gjithëpërfshirjes* së procesit të regjistrimit të zgjedhësve; dhe
- ▢ Përdorimin e listave të zgjedhësve dhe vëzhgimin në ditën e *zgjedhjeve*.